

Prof. Dr. Enver Sopjani
M.Sc. Naser Sopjani

**ROLI I ENKLAVAVE
DHE STRUKTURAVE
ILEGALE SERBE NË KOSOVË**

- Studim shkencor -

Prishtinë, 2012

Prof. Dr. Enver Sopjani
M.Sc. Naser Sopjani, PhD cand

Autorë dhe botues: Prof. Dr. Enver Sopjani dhe M.Sc. Naser Sopjani, PhD cand.

ROLI I ENKLAVAVE DHE STRUKTURAVE ILEGALE
SERBE NË KOSOVË

© AUTORËT

Katalogimi në botim- (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

323.15(496.51)(048)
341.234(496.51)(048)

Sopjani, Enver
Roli i enklavave dhe strukturave ilegale serbe në
Kosovë / Enver Sopjani, Naser Sopjani. - Prishtinë:
[Autorët], 2012. - 132 f. ; 21 cm.

Parathënie: f. 5-7. – Literatura : f. 125-127.- Autorët : f.
131-132

1. Sopjani, Naser

ISBN 978-9951-8867-0-3

Prishtinë, gusht 2012

*Kushtuar prindërve dhe të parëve tanë,
si dhe të gjithë atyre që luftuan dhe
dhanë jetën për kombin shqiptar!*

PARATHËNIE

“Roli i enklavave dhe strukturave ilegale serbe në Kosovë” ka dalë si fryt i një hulumtimi që është bërë në këtë fushë nga ana e autorëve.

Autorët e këtij punimi të përbashkët dhe të shkurtër, vëllezërit Enver dhe Naser Sopjani, kanë trajtuar pozitën e minoritetit serb në Kosovë, duke analizuar përfitimet dhe privilegjet që ata i gëzojnë në njërin anë dhe refuzimin e pakënaqësinë e tyre, në anën tjetër.

Autorët trajtojnë ndikimin e madh politik dhe ekonomik që ka Serbia në destabilitetin dhe moskuptimin e realitetit shtetëror të Kosovës nga ana e serbëve, por edhe ndikimin në aspektin e kriminalitetit dhe rritjes së tij në këto enklava dhe në tërë Kosovën.

Enklavat serbe në Kosovë janë strehë e mirë për fshehjen dhe kultivimin e krimit, i cili në njëfarë mënyre amnistohet dhe mbrohet edhe nga ndërkombëtarët.

Tërë punimi është i sistemuar në dy pjesë të ndara të vendosur në kapituj, duke respektuar rregullat e punimeve shkencore ndërkombëtare.

Pjesa e parë është e përgatitur nga autori Enver Sopjani dhe trajton problemin në raport të ndikimit të Serbisë si krijuese dhe financuese e këtyre strukturave ilegale të minoritetit serb, mospërfillja e institucioneve të Kosovës nga ana e këtyre strukturave, sjellja e tyre pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe roli i bashkësisë ndërkombëtare në vënien e rendit dhe ligjit nëpërmjet luftimit të kriminalitetit serb në këto enklava e më gjerë.

Pjesa e dytë është e përgatitur nga Naser Sopjani dhe problemin në fjalë e ka trajtuar në raportin se si minoriteti serb e ka pranuar shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe si i pranon institucionet e saj.

Fillimisht trajton Kushtetutën e Republikës së Kosovës me garancitë e saj dhe të drejtat dhe privilegjet që ajo i ka garantuar në nenet e saj. Autori trajton qasjen e minoritetit serb ndaj policisë, ndaj institucioneve shkollore, gjyqësore dhe komunave. Vend të veçantë i është dhënë edhe financimit të Serbisë që u bënë këtyre strukturave ilegale dhe të cilat

janë indikatorët dhe ndër arsyet kryesore të jetëgjatësisë së këtyre organizimeve kriminale dhe të armatosura, por edhe pengesë për qasje me kohë dhe pranim të shtetit të pavarur të Kosovës.

Të vetëdijshëm që nuk është thënë tërë ajo çka do të mund të thuhet, autorët me punën e tyre kanë dhënë një kontribut, i cili duhet të vazhdohet dhe të trajtohet edhe nga të tjerët. Tema e trajtuar është e rëndësishme së veçantë për shtetësinë e Kosovës dhe të ardhmen e saj, për të gjithë banorët e saj, si shqiptarët, ashtu edhe minoritetet përbërëse të saj.

Autorët

Prishtinë, gusht 2012

PËRMBAJTJA

Pjesa e parë

Prof. Dr. Enver Sopjani

Strukturat ilegale të minoritetit serb në Kosovë si dhe qëndrimi i Serbisë dhe i bashkësisë ndërkombëtare karshi tyre..... 13

| | |
|--|----|
| 1. Hyrje..... | 13 |
| 2. Minoriteti serb në Kosovë, strukturat e tij ilegale si dhe roli i Serbisë..... | 15 |
| 2.1. Mospërfillja e hierarkisë së komandës së Policisë së Kosovës nga ana e minoritetit serb..... | 18 |
| 2.2. Sjellja e Serbisë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës..... | 23 |
| 2.3. Përndjekja dhe dënimi i kriminelëve serbë të luftës..... | 29 |
| 3. Roli i ndërkombëtarëve në luftimin e kriminalitetit serb dhe vënies së rendit dhe ligjit në Kosovë..... | 41 |
| 4. Përmbledhje..... | 57 |
| 5. Literatura..... | 71 |
| 6. Shkurtesat..... | 81 |

Pjesa e dytë

M.Sc. Naser Sopjani

Qasja e minoritetit serb ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës..... 85

| | |
|--|-----|
| 1. Hyrje..... | 85 |
| 2. Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe të drejtat e minoritetit serb sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës | 89 |
| 3. Qasja e minoritetit serb ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës..... | 97 |
| 3.1. Qasja e minoritetit serb ndaj Policisë së Kosovës | 97 |
| 3.2. Qasja e minoritetit serb ndaj institucioneve shkollore | 101 |
| 3.3. Qasja e minoritetit serb ndaj institucioneve gjyqësore | 103 |
| 3.4. Qasja e minoritetit serb ndaj komunave..... | 104 |
| 4. Financimi i Serbisë në minoritetin serb të Kosovës..... | 113 |
| 5. Strukturat kriminale të armatosura serbe në Republikën e Kosovës..... | 115 |
| 6. Përmbledhje..... | 123 |
| 7. Literatura | 125 |
| 8. Shkurtesat..... | 129 |
| Autorët..... | 131 |

Pjesa e parë

Prof. Dr. Enver Sopjani

**STRUKTURAT ILEGALE TË MINORITETIT
SERB NË KOSOVË SI DHE QËNDRIMI I
SERBISË DHE I BASHKËSISË
NDËRKOMBËTARE KARSHI TYRE**

1. HYRJE

Trajtimi i strukturave ilegale të minoritetit serb në Kosovë si dhe qëndrimi i Serbisë dhe i bashkësisë ndërkombëtare karshi tyre është më se i nevojshëm, pasi që këto struktura ilegale janë rreziku më i madh jo vetëm për shtetësinë e Kosovës, por edhe për stabilitetin në rajon. Qëndrimi i Serbisë karshi tyre është destruktiv, pasi që ato jo vetëm se i ka themeluar,

por edhe i ka financuar gjithë kohën. Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare jo vetëm se e ka lejuar themelimin dhe funksionimin e tyre, duke mos ndërmarrë masa kundër atyre strukturave, por ajo pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës mundohet t'ua imponojë institucioneve të Kosovës që ato të legalizohen.

Duke marrë parasysh se këtu kemi të bëjmë me një temë lidhur me të cilën mund të shkruhen mijëra faqe, ky punim mundohet ta trajtojë këtë problem në pika të shkurtra, në mënyrë që lexuesi ta ketë një qasje të shpejtë në këtë fenomen, i cili është duke prodhuar vetëm destabilitet dhe pasiguri në Kosovë dhe në Ballkan. Trajtimi jo i barabartë i popullit shumicë shqiptar karshi atij pakicë serb në Kosovë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare paraqet po ashtu një fakt shqetësues dhe prodhon një pasiguri shtesë te populli shumicë shqiptar në Kosovë.

2. MINORITETI SERB NË KOSOVË, STRUKTURAT E TIJ ILEGALE SI DHE ROLI I SERBISË

Problemi kryesor ose pengesë në luftën kundër krimit të organizuar janë enklavat serbe, ku dora e ligjit dhe e policisë nuk i mbulon si duhet që nga viti 1999. Kjo konfirmohet edhe nga fakti se jo vetëm kontrolli i kufirit në veri të Mitrovicës nuk është duke funksionuar, por në shkurt 2008 pikat policore dhe doganore Nr.1 dhe Nr. 31 u dogjën dhe u shkatërruan nga serbët. Një fakt të dhimbshëm paraqet edhe data 5 mars 2009, kur drejtori i atëhershëm i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, si dhe shefi i atëhershëm i Policisë së EULEX-it, Rainer Kuehn, u penguan nga grupet serbe për të vizituar stacionet e policisë në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, si dhe pikën nr. 31 të kontrollit kufitar.¹

Nënkryetarja e Këshillit Kombëtar Serb në Kosovë, Rada Trajković, tha në një takim në Çagllavicë afër Prishtinës në shtator 2008 se ajo kishte menduar se djegia dhe shkatërrimi i pikave kufitare në pjesën veriore të Mitrovicës nga serbët

¹ Krahaso, Zëri i Ditës, gazetë ditore: Serbët pengojnë vizitën e Ahmetit dhe Kuehenit në stacionet policore në veri, Nr. 2816, më datën 6.3.2009, f. 2.

ishite "një demonstratë kundër pavarësisë apo një lloj mbështetje për sistemin serb".² Më vonë ajo kishte parë sesi mallrat dhe nafta pa tatim kontrabandoheshin për në Kosovë, gjë që, sipas saj, mund të çojë në krijimin e një rrjeti kriminal.³

Fatkeqësisht Shërbimi sekret serb është duke punuar kundër stabilitetit të Kosovës dhe mbështet strukturat paralele ilegale serbe në Kosovë, të cilat krijojnë situatë jostabile. Aktiviteti ilegal i Serbisë në Kosovë nëpërmjet shërbimit të fshehtë të saj nuk është ndalur edhe pas vendosjes së strukturave ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999. Nga ana tjetër, edhe agjencitë e huaja të shërbimeve sekrete kanë ndjekur gjithë kohën interesat e tyre dhe nuk kanë bashkëpunuar si duhet as brenda bashkësisë ndërkombëtare, por as me institucionet e Kosovës. Qeverisë së Kosovës gjatë gjithë periudhës së administratës së UNMIK-ut (1999-2008) nuk iu lejua krijimi i shërbimit sekret. Edhe pas krijimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2006, Kosovës nuk iu lejua krijimi i një shërbimi sekret vendës, të paktën në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe pse një shërbim sekret kosovar

² Trajković, Rada në Lajmet qendrore të RTK-së më datën 29.9.2008 në ora 19:30.

³ Krahaso, Rada Trajković, po aty.

do kishte qenë që atëherë shumë i dobishëm për mënjanimin e rreziqeve kundër stabilitetit të Kosovës. Komandanti i NATO-s, admirali i SHBA-së, Mark Fitzgerald, përgjegjës i NATO-s për Juglindje⁴, gjatë vizitës së tij në Prishtinë, më 18 shkurt 2010, tha:

“Çdo strukturë paralele që mund të ekzistojë në Kosovë është e rrezikshme për vendin. Ato, siç kemi thënë më parë, nuk duhet të ekzistojnë. Por, nëse ato veprojnë, e në këtë rast shkaktajnë një kërcënim, atëherë ne jemi të gatshëm të veprojmë, sepse ne jemi këtu në bazë të Rezolutës 1244 dhe kemi për detyrë të sigurojmë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë”⁵.

⁴ http://www.rp-online.de/politik/ausland/Deutschland-uebernimmt-Kommando-ueber-Nato-Truppen_aid_755181.html, qasur më datën 19.2.2010.

⁵ <http://www.rtklive.com/new/>, qasur më datën 19.2.2010, si dhe: RTK-Lajmet e Mëngjesit “Mirëmëngjesi Kosovë” më datën 19.2.2010 në ora 8:00.

2.1. MOSPËRFILLJA E HIERARKISË SË KOMANDËS SË POLICISË SË KOSOVËS NGA ANA E MINORITETIT SERB

Kosova shpalli më 17 shkurt 2008 pavarësinë e saj, por më 29 shkurt 2008, 300 serbë të Policisë së Kosovës refuzuan të jenë nën hierarkinë komanduese të Policisë së Kosovës. Ata kërkuan të mos jenë më nën komandën e Policisë së Kosovës, por të Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë. Për këtë arsye ata u suspenduan nga puna, ndërsa pagat i merrnin edhe më tutje. Zëvendëskomisari i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, deklaroi atë kohë se ky suspendim me pagesë për 285 zyrtarë të Policisë, të cilët ende nuk janë kthyer në shërbim, do të jetë i vlefshëm deri më 30 maj 2008. Kjo deklaratë erdhi pasi Inspektorati i Policisë kishte dhënë rekomandim të ndërpresë pagesën për zyrtarët e pezulluar të Policisë.⁶

Vendimi për suspendim pa pagesë është marrë më 30 maj 2008, “në orën 8”⁷, sepse zyrtarët e Policisë kishin deri atëherë kohë për t’u kthyer. Pasdite, Ministria e Punëve të

⁶ Krahso, Lajm, e përditshme informative, Nr. 1129, më datën 31.05.2008. Vendime brenda dite, f. 5.

⁷ Koha Ditore, Nr. 3937, më datën 31.05.2008. “Qeveria nuk lejon suspendimin pa pagesë të policëve serbë, f. 2.

Brendshme deklaroi se afati i caktuar i suspendimit do të zgjatet, duke i ruajtur pagat.⁸ Kjo erdhi pasi që kryeministri Hashim Thaçi bëri deklaratën në vijim lidhur me vendimin e Ahmetit për suspendimin pa pagesë:

*“Përfundimisht duhet ta keni të qartë: Ju nuk mund të shkarkoni, nuk mund të emëroni, nuk mund të suspendoni, nuk mund t’i ndërprisni pagat dhe nuk mund të largoni njerëz nga puna pa një vendim unanimit të Qeverisë”.*⁹

Kjo deklaratë e Qeverisë është bërë për shkak të presionit nga bashkësia ndërkombëtare, sepse suspendimi ishte vetëm një çështje e Komandës së Policisë dhe vendimi i Qeverisë ishte vendim politik. Shumë shqiptarë, pjesëtarë të policisë, pas këtij vendimi u zemëruan dhe janë ndier të trajtuar në mënyrë jo të barabartë. Afati për kthim ishte vazhduar përsëri. Më 30 qershor 2009, në një konferencë shtypi nga ana e Policisë së

⁸ Krahaso, Lajm, e përditshme informative, Nr. 1129 of 31.05.2008, si më lart.

⁹ Express, Nr. 1170 of 31.05.2008. Flakaresha për Gjeneralin, f. 6.

Kosovës, u bë e ditur se shumica e policëve të suspenduar të pakicës serbe ishin kthyer në punë. Kthimi u bë si më poshtë:

- Në rajonin e Prishtinës u kthyen 113 nga 114 zyrtarë të suspenduar të Policisë,
- Në rajonin e Gjilanit u kthyen 125 nga 129 zyrtarë të suspenduar të Policisë,
- Në rajonin e Pejës u kthyen 7 zyrtarë të suspenduar të Policisë,
- Brenda Policisë Kufitare u kthyen 48 nga 50 zyrtarë të suspenduar të Policisë dhe
- Brenda menaxhmentit të përgjithshëm u kthyen 13 nga 24 zyrtarë të suspenduar të Policisë.

Edhe në Mitrovicë u kthye një polic i suspenduar në shërbim të Policisë së Kosovës.¹⁰ Në anën tjetër, serbi Zoran Simiq, i cili nuk e ka refuzuar shërbimin në Policinë e Kosovës, më 29 qershor 2009 deklaroi:

“Unë policët që do të kthehen në punë nuk do t’i pranoj. Unë do të punoj me ta, por

¹⁰ Krahaso, Ministria e Punëve të Brendshme: Shumica e policëve serbë të suspenduar u rikthyen në Policinë e Kosovës, Prishtinë, 1.8.2009, <http://www.mp-ks.org/?page=1,46,291>, qasur më datën 1.8.2009.

*respektin që kisha më herët për kolegët e mi serbë nuk do ta kem më. Unë e kam humbur respektin për ta, sepse, pasi që unë kisha vendosur të mos e lëshoj punën, më kanë konsideruar si tradhtar. Ata nuk e pranuan vendimin tim dhe unë nuk do të toleroj që mbikëqyrësi im të jetë ndonjë serb i cili pritet të kthehet në punë. Unë do të shkoj të shërbej në Viti, në polici, ku si mbikëqyrës do ta kem një shqiptar”.*¹¹

Një deklaratë të tillë publike nuk mund ta bënte asnjë polic shqiptar, për shkak se do të përballeshin me pasoja. Një zyrtar i Policisë i Shërbimit Policor të Kosovës në mënyrë anonime tha si në vijim:

“Pakicat i kanë te ne të gjitha të mirat. Serbët nuk kanë ardhur në punë që disa muaj dhe marrin paga njësoj si ne që punojmë dhe që i ekspozohemi rrezikut çdo

*ditë. Shpesh bëj shaka me pakicat e tjera që vijnë në punë. U them atyre: Çfarë jeni duke bërë ju këtu në punë, kur mund t'i merrni pagat e njëjta edhe po nuk erdhët në punë. Ata qeshin dhe thonë se nuk janë të sigurt nëse kjo vlen edhe për ta”.*¹²

Edhe pse në zona të tjera të Kosovës pjesëtarët e Policisë nga pakica serbe u kthyen në Polici të Kosovës dhe i janë nënshtruar komandës së Shërbimit Policor të Kosovës, në veri të Kosovës ata refuzojnë edhe më tej të jenë nën komandën e Shërbimit Policor të Kosovës, respektivisht nën Drejtorinë e Përgjithshme, edhe pse pagat e atyre zyrtarëve paguhën drejtpërdrejt nga kasa e Shërbimit Policor të Kosovës. Strategjia politike e bashkësisë ndërkombëtare (e UNMIK-ut dhe OSBE-së), për të krijuar stacione të policisë krejtësisht etnike në enklavat serbe, ka dëshmuar të jetë e gabuar. Nëse bashkësia ndërkombëtare pjesëtarët e Policisë së pakicës serbe do t'i shpërndante në stacionet e policisë nëpër gjithë territorin e Kosovës, sot të gjitha stacionet e

¹¹ Simic, Ziran: Zyrtar serb i Policisë së Kosovës, në: RTK-Lajmet Qendrore më datën 29.6.2009 në ora 19:30.

¹² Bisedë me zyrtarin e Policisë së Kosovës X-4 në Prishtinë më datën 18.5.2009.

policisë dhe pikat kufitare do të ishin nën komandën e Drejtorisë së Përgjithshme dhe ligji sipas të gjitha gjasave do të zbatohet edhe në Veri. Në anën tjetër, edhe institucionet e vendit është dashur që të paktën pas shpalljes së pavarësisë të jenë më të vendosura për zhbërjen e këtyre strukturave ilegale dhe të mos tërhiqen dhe t'ua lënë në dorë këtë çështje ndërkombëtarëve, kur dihet se ndërkombëtarët janë ata që e kanë mundur krijimin e këtyre strukturave. Kurse pagesa e policëve serbë të suspenduar ka qenë jo vetëm e padrejtë, por ka shkuar në kurriz të popullit shqiptar të Kosovës, i cili nuk merr paga nga dy shtete të ndryshme sikurse shumica e minoritetit serb, duke marrë paga nga Kosova dhe Serbia. Përveç kësaj, ata janë financuar dhe financohen, në formë të projekteve të ndryshme, edhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

2.2. SJELLJA E SERBISË PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Se qeveria serbe është aktive në Kosovë dhe është duke punuar kundër stabilitetit, na dëshmon edhe incidenti i 17 dhe 18 marsit 2008, kur gjatë pushtimit të ndërtesës së Gjykatës në Mitrovicë prej serbëve, nga ana e Policisë së UNMIK-ut,

janë identifikuar punonjës të Qeverisë, respektivisht të organeve të Sigurimit të Shtetit të Serbisë.

Shtetet fqinje reagojnë në mënyra të ndryshme lidhur me pavarësinë e Kosovës. Për dallim nga Shqipëria, e cila njohu pavarësinë e Kosovës më 18 shkurt 2008, do të thotë të nesërmen, njohja e pavarësisë së Kosovës nga dy vendet fqinje, Maqedonia dhe Mali i Zi, u bë vetëm më 9 tetor 2008. Ndërsa, Serbia vazhdon të kundërshtojë pavarësinë e Kosovës dhe punon në të gjitha drejtimet për ta ndaluar njohjen e mëtejshme të pavarësisë së Kosovës. Ish-ministri serb i Punëve të Jashtme, Vuk Jeremiq, tha më 17 shkurt 2010 për gazetën e Beogradit 'Blic' se lufta diplomatike e Serbisë kundër Kosovës ka tri prioritete:

1. Parandalimin e njohjeve të mëtejshme të Kosovës si shtet i pavarur,
2. Parandalimin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe

3. Njoftimin e komunitetit ndërkombëtar për kinse shkeljen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti të gjoja kufizimit të lëvizjes së lirë të serbëve në Kosovë.¹³

Serbia paraqet pengesa edhe në arenën ndërkombëtare jo vetëm në njohjen e Kosovës si shtet i pavarur, por edhe në pjesëmarrjen e shtetasve të Kosovës në sportin ndërkombëtar si përfaqësues të Kosovës apo si sportistë vetjakë, siç ishte rasti i fundit i sportistes Majlinda Kelmendi. Kurse bashkësia ndërkombëtare e përkrah Serbinë dhe e trajtojnë Kosovën në mënyrë të njëanshme dhe të padrejtë, kur kemi parasysh se OKB-ja ka 193 anëtarë, të cilët i njef si shtete të pavarura, kurse Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, i cili e përkrah Serbinë dhe e pengon pjesëmarrjen e sportit kosovar, ka 204 anëtarë,¹⁴ gjë që do të thotë gjithsej 11 joanëtarë të OKB-së, duke e përfshirë edhe Palestinën.

¹³ Krahaso, Jeremic: Tri prioritete të luftës për Kosovën, ne: <http://www.rtklive.com/new/?cid=news>, qasur më datën 18.2.2010.

¹⁴ Krahaso, The mission of the National Olympic Committees (NOCs) is to develop, promote and protect the Olympic Movement in their respective countries, <http://www.olympic.org/ioc-governance-national-olympic-committees>, qasur më datën 29.5.2012.

Propaganda serbe, e cila është e bazuar në shpifje, ishte edhe në kohën e regjimit të Milosheviqit në rend të ditës. Se kjo sjellje për serbët nuk është e re, është konfirmuar edhe në vitin 1914, kur socialisti i famshëm serb, Dimitrije Tucoviq dhe kolegët e tij përshkruan se si Serbia gjatë luftërave ballkanike kishte pushtuar Kosovën dhe Shqipërinë, kishte grabitur dhe kishte kryer kundër popullsisë së pafajshme shqiptare masakra të papara. Në të njëjtën kohë ajo kishte përhapur në Evropë çdo ditë propaganda dhe kishte akuzuar shqiptarët për kinse kryerjen e krimeve kundër ushtrisë serbe.¹⁵

Anëtari i Akademisë së Shkencave të Kosovës, Mark Krasniqi, tha më 15 tetor 1992 para Parlamentit belg në Bruksel se edhe “vetë ideologu i Serbisë së Madhe, akademiku Jovan Cvijiq (1910) shkruante se serbët në Kosovë kanë përbërë gjithmonë vetëm një pakicë të vogël, rreth 5% të popullsisë së përgjithshme”¹⁶. Akademiku Mark Krasniqi ka cituar nga revista e Beogradit “Vreme” e 9

¹⁵ Krasniqi, Mark: Kosova heute: Referat vor dem belgischen Senat am 15. Okt. 1992 (Kosova sot: Referat para Senatit belg më 15 tetor 1992), Prishtina 1992. Aus dem Albanischen übersetzt von Hans-Joachim Lanksch. Hrsg.: E. Nujici, 1. Aufl., Frankfurt/Main: Wernicke 1997, f. 9.

¹⁶ Po aty, f. 19.

dhjetorit 1991 Stefan Dedijerin, që jeton në Suedi, i cili thotë: “Vizioni shovinist i politikës hegjemoniste serbe do të thotë se serbët duhet ta kenë regjimin mbi të gjitha kombet në Jugosllavi, për të bërë nga Jugosllavia atë që kanë bërë nga Kosova - një shtet policor”¹⁷. Krasniqi i referohet edhe një akademiku tjetër serb, Mica Popoviq, i cili ishte shprehur:

*“Serbët nuk janë mësuar me demokraci, kështu që ata në këtë lëmi kanë nevojë të mësojnë shumë (...). Populli serb është i prirë të mendojë për veten shumë më mirë sesa në të vërtetë është (...). Serbët janë të bindur seriozisht dhe besojnë se edhe zoti është një serb”.*¹⁸

Në lidhje me këtë Krasniqi thotë:

“Kështu serbët mendojnë gjithashtu se edhe fati i popullit shqiptar duhet të shtrihet në duart e tyre dhe tokat e tyre historike dhe

¹⁷ Po aty, f. 22.

¹⁸ Po aty, f. 22.

*etnike duhet të jenë në pronësi të serbëve. Për të realizuar këtë ëndërr të tyre dhe agoni të vazhdueshme ata paraqesin gënjeshtër marramendëse dhe zhvillojnë një terror dhe gjenocid të paparë mbi popullin shqiptar. Dhuna dhe gënjeshtër janë një princip i përhershëm i politikës serbe, siç thotë edhe vetë Dobrica Qosiq: “Gënjeshtër është një formë e patriotizmit tonë dhe një dëshmi e inteligjencës sonë natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krative, fantastike dhe imagjinuese” (në enciklopedinë e aforizmave “Velika Epohina enciklopedija aforizama”, Zagreb, 1968, f. 264, Cosic Roman “Seobe”).*¹⁹

Kjo strategji e gënjeshtërve u konfirmua edhe më 17 shkurt 2010 nga ana e ministrit serb të Punëve të Jashtme, Vuk Jeremiq, kur ai tha për gazetën e përditshme të Beogradit më 18 shkurt 2010 që të gjithë ambasadorët serbë e kanë për

¹⁹ Po aty, f. 22-23.

detyrë t'i informojnë²⁰ shtetet mike në detaje për kinse shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, edhe pse realiteti në Kosovë duket krejtësisht ndryshe dhe pakicat janë edhe me Kushtetutë shumë të privilegjuar si në asnjë vend tjetër të botës.

Një problem tjetër është fakti se te serbët ende nuk është bërë një ndarje reale në mes të kishës dhe politikës, respektivisht fesë dhe shtetit. Populli serb është i manipuluar me forcë dhe i ndikuar negativisht si nga politika, ashtu edhe nga kisha ortodokse, e cila përzihet edhe në politikë.

2.3. PËRNDJEKJA DHE DËNIMI I KRIMINELËVE SERBË TË LUFTËS

Më 8 nëntor 1994 nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së u themelua Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi me seli në Hagë. Ky Tribunal funksionon si një Gjykatë Ndërkombëtare Penale dhe merret me përndjekjen e veprave penale të gjenocidit apo të personave të cilët kanë kryer apo kanë urdhëruar shkeljet e të drejtave të njeriut apo

²⁰ Krahaso, Jeremij: Tri prioritete të luftës për Kosovën, si më lart.

të krimeve kundër njerëzimit.²¹ Neni 39 i Kartës së OKB-së vlerëson se çfarë masash të parashikuara në Nenin 41 dhe Nenin 42 duhet të merren nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në rast të kërcënimit të paqes.

Sipas Nenit 41 të Kartës së OKB-së parashihet urdhërimi i masave sanksionale pa përdorimin e forcës së armatosur, kurse sipas Nenit 42 mund të urdhërohet edhe përdorimi i forcës së armatosur nëse konstatohet se sanksionet e urdhëruara sipas Nenit 41 nuk kanë treguar rezultate. Krijimi i Tribunalit Penal të OKB-së për ish-Jugosllavinë, sipas Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurimit, për t'i ndjekur penalisht dhe për t'i dënuar kriminelët e luftës “paraqet një sanksion të tillë sipas Nenin 41 të Kartës së OKB-së”²² - dhe

²¹ Krahaso, Der Fischer Weltalmanach 2000 (Hrsg.): Zahlen, Daten, Fakten (Almanahu botëror 2000 i Fischer-it: Shifrat, Të dhënat, argumentet). Fischer Taschenbuch Verlag GmbH, Frankfurt am Main 1999, f. 1015.

²² Arnold, Pascal (Hrsg.): Der UNO- Sicherheitsrat und die strafrechtliche Verfolgung von Individuen: die ad-hoc Tribunale zur Verfolgung von Kriegsverbrechen im ehemaligen Jugoslawien und in Ruanda sowie das Statut des Internationalen Strafgerichtshofs (Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe ndjekja penale e individëve: Tribunali ad hoc për përndjekjen e kriminelëve të luftës në ish-Jugosllavi, Ruandë si dhe Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Penal), Institut du Fédéralisme Fribourg, Suisse.- Basel: Genf; München: Helbing und Lichtenhahn, 1999 f. 64 deri 129, këtu f. 69.

atë në bazë të Nenit 39 të Kartës së OKB-së. Por, nëse marrim parasysh se vetëm një numër i vogël i kriminelëve të luftës i janë dorëzuar vullnetarisht Tribunalit dhe se për këtë arsye për arrestim duhet përdorur edhe forcën e armëve, atëherë shtrohet pyetja se a bëhet fjalë këtu për masat e parapara sipas Nenit 42 të Kartës së OKB-së.

Edhe pse kjo gjykatë penale e OKB-së, gjegjësisht ky Tribunal Penal është përdorur nga ana e Këshillit të Sigurimit si një organ ndihmës sipas Nenit 29 të Kartës së OKB-së, statusi i këtij gjyqi parasheh “një pavarësi të zgjeruar hierarkike të Gjykatës nga Këshilli i Sigurimit”²³ të OKB-së. Karakteristikat e pavarësisë së këtij gjyqi janë zgjedhja e kryetarit nga ana e Gjyqit dhe përjashtimi i mundësisë që qeveritë apo Këshilli i Sigurimit të kenë ndikim të drejtpërdrejtë apo tërthorazi në punën e Gjykatës. Kështu rregullohet së paku nga statuti i kësaj gjykate. Është një gjë tjetër se a ndodh në të vërtetë kështu.

Tribunali për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë ka formuar në maj 1998 (me leje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së) trupin

²³ Arnold, Paskal, po aty, f. 73.

e tretë gjyqësor me tre gjyqtarë të tjerë, për të mundësuar një punë të suksesshme të Tribunalit. Deri në vitin 1999 janë akuzuar 84 persona, prej tyre 6 të akuzuar kanë “vdekur”²⁴, kurse kundër 18 të akuzuarve është tërhequr akuza. “Në fund të majit 1999 ishin të ngritura 24 akuza kundër 64 personave. Në paraburgim ishin 25 të akuzuar. Deri në fund të majit 1999 u dënuan gjithsej 8 të akuzuar, kurse një i akuzuar ishte shpallur i pafajshëm”²⁵. Më 27 maj 1999 nga Tribunali u akuzua presidenti i atëhershëm i Jugosllavisë, Slobodan Milosheviq dhe tre politikanë të tjerë të lartë, duke përfshirë edhe presidentin e Serbisë, Milan Milutinoviq, zëvendëskryeministrin jugosllav, Nikola Shainoviq dhe ministrin e Brendshëm serb, Vljako Stojilkoviq, si dhe shefin e Shtabit, Dragoljub Ojdaniq, për vrasjen dhe dëbimin e civilëve shqiptarë.²⁶ Në bazë të statistikës aktuale (maj 2012) nga Tribunali Penal i Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë janë akuzuar deri gjithsej 161 persona, 126 procedura kanë përfunduar, kurse 35 procedura gjenden në zhvillim e sipër. Në 126 procedurat e përfunduara gjenden 64

²⁴ Është në pikëpyetje se a kanë vdekur me të vërtetë apo janë shpallur si të vdekur.

²⁵ Der Fischer Weltalmanach 2000, si më lart, f. 1015.

²⁶ Krahaso, po aty, f. 1015.

dënime dhe 13 shpallje pafajësie. 13 procedura janë transferuar në gjykatat nacionale, 10 të akuzuar kanë vdekur para se të transferohen në Gjykatën e Hagës, kurse 6 kanë vdekur pas transferimit të tyre në Hagë, në mesin e tyre ishte edhe ish-krimineli Slobodan Milosheviq, i cili ka vdekur në Hagë më 11 mars 2006²⁷.

Në lidhje me punën e Tribunalit Penal të OKB-së për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën ka pikëpamje të ndryshme. Një nga pikëpamjet paraqitet si në vijim:

"Në 50 vjetët e fundit ka pasur konflikte të shumta me krime të panumërta të luftës, si p.sh. në Kamboxhia, Irak, Liban, Vietnam, Kore, Tibet, Sudan, Afganistan, Turqi, Çeçeni, Algjeri, Somali, Nikaragua dhe El Salvador (...) Autorët e krimeve shpeshherë kanë mbetur të pandëshkuar, edhe pse shumica prej tyre ishin të njohur. Fakti se

²⁷ Vgl. International Criminal Tribunal for Ex-Yugoslavia: Status of Cases, http://www.icty.org/x/file/Cases/keyfigures/key_figures_120302_en.pdf, qasur më datën 20.5.2012.

kjo luftë u zhvillua në Evropë dhe se asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk ishin të përfshira drejtpërdrejt në luftë, ka qenë në masë të madhe vendimtar, që krimet e luftës në ish-Jugosllavi të ndiqen në nivel ndërkombëtar".²⁸

Është e vërtetë se krime lufte janë bërë edhe diku tjetër, të cilat nuk janë dënuar kurrë. Por OKB-ja nuk ishte e përgatitur për këtë detyrë që të jetësonte një Gjykatë të Pavarur të OKB-së për Krime për të gjitha këto rajone. Jo që kjo do t'i kushtonte OKB-së shumë para, por pasi që atje ishin të përfshira drejtpërdrejt apo tërthorazi disa Fuqi të Mëdha, të cilat nuk do ta kishin lejuar një gjë të tillë. Fundja, të dy gjykatat penale të OKB-së (për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën) sollën disa kriminelë të luftës para drejtësisë dhe kështu i treguan botës që krimet ndaj njerëzimit nuk mund të mbeten "tërësisht" pa u ndëshkuar. Megjithatë, themelimi i Gjykatës Penale për ish-Jugosllavinë ishte shumë i rëndësishëm si dhe një test për gjykatat penale ndërkombëtare të krijuara më vonë. Më 22 nëntor 1997

²⁸ Arnold, Pascal, si më lart, f. 76.

Profesor Mujë Rugova, i cili aktualisht është Rektor i Universitetit të Prishtinës, kishte shkruar:

“Në fund të muajit tetor, në Serbi ishte raportuar me një prezantim të fryrë që institucione dhe personalitete të ndryshme, siç është Akademia e Arteve dhe Shkencave e Serbisë, intelektualë, artistë, politikanë, duke përfshirë Pavlin, njeriun e parë të Kishës Ortodokse Serbe, kishin kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare në Hagë që kriminelin ordinar Radovan Karaxhiq ta largojnë nga ndjekja penale. (...). Kjo pararojë e krimit bëri apelim nëpërmjet shoqërisë serbe të artistëve dhe shkrimtarëve në Beograd dhe përpiqet të luajë edhe këtë herë lojën e vjetër që ta largojë fajin sa më larg që është e mundur nga serbët dhe populli serb, si gjithmonë t’ua vërë fajin viktimave ose të marrë në mbrojtje kriminelë të caktuar me qëllim që

*këtë popull kriminal ta mbrojë nga dënimi“.*²⁹

Ndjekja penale dhe dënimi i serbëve të cilët ishin të përfshirë në krime kundër popullsisë shqiptare ka qenë gjithmonë e vështirë, sepse bashkësia ndërkombëtare në këtë mënyrë mendohej t’i shmangej dhunës eventuale në Kosovë, gjë që shfaqti zemërim në mesin e popullsisë shqiptare.

Propozimin dhe përpjekjen e Serbisë që me ndihmën e OKB-së ta quajë Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës të paligjshme, profesori i Juridikut si dhe ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, më 29 shkurt 2008 e quajti si një përpjekje legjitime ligjore të një kriminelit, duke thënë:

“Serbia do të përpiqet të gjejë njerëz për të mbrojtur krimet e saj. E them më se

²⁹ Krahaso, Rugova, Mujë: Beistand von serbischen Intellektuellen (Përkrahja e intelektualëve serbë), në Frankfurter Allgemeine Zeitung më datën 22.11.1997, f. 10.

drejtpërdrejt. Por e them edhe një gjë: edhe kriminelët kanë të drejtë të ankohen“.³⁰

Kur më 26 shkurt 2009 Gjykata e OKB-së dënoi pesë serbë me burgim të gjatë deri në 22 vjet për krim kundër popullatës shqiptare të Kosovës, ministri i Punëve të Brendshme, Ivica Daciq, i cili ishte më herët edhe zëdhënës i Slobodan Milosheviqit, tha se ky proces ka qenë që nga fillimi një “proces politik kundër Serbisë“³¹. Në anën tjetër, Serbia ka bërë dhe bën çmos që t’i fshehë krimet e bëra kundër popullit shqiptar apo t’i balancojë nëpërmjet akuzave të ndryshme dhe të paqëndrueshme kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së, të cilat fatkeqësisht shpesh edhe janë marrë në konsideratë edhe nga ana e Tribunalit/Gjykatës së Hagës për ish-Jugosllavinë apo organet e tjera ndërkombëtare të drejtësisë në Kosovë në kuadër të UNMIK-ut dhe EULEX-it. Por nuk duhet harruar fakti se tribunalet ndërkombëtare ushtarake penale të Nürnbergut (Gjermani) dhe të Tokios (Japoni) kanë përndjekur dhe kanë dënuar vetëm gjermanët

³⁰ Sejdiu, Fatmir, në: Lajmet qendrore në RTK më datën 29.9.2008 në ora 19:30.

³¹ Serbien fühlt sich von UN-Tribunal „vergewaltigt“ (Serbia e ndien veten të „përdhunuar“), në: Die Welt më datën 28.2.2009, f. 6.

dhe japonezët, dhe jo edhe amerikanët apo rusët. Edhe amerikanët patën hedhur në Japoni (Hiroshimë) dy bomba atomike, ku ka pasur civilë të vdekur, kurse në anën tjetër, rusët gjatë marshimit të tyre në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë vrarë dhe kanë përdhunuar civilë gjermanë dhe nuk janë përndjekur dhe as dënuar. Kurse Tribunali Penal i OKB-së për ish-Jugosllavinë ka përndjekur dhe ka dënuar (gjë të cilën e bën ende) jo vetëm serbët, të cilët i kanë filluar luftërat dhe i kanë kryer krimet, por edhe kroatë, boshnjakë dhe shqiptarë, edhe pse ata kanë qenë në anën e viktimës. Një trajtim i tillë dhe jo i barabartë ndodh vetëm se Serbia në anën e saj e ka Rusinë dhe Kinën, si forca atomike dhe anëtare të OKB-së me të drejtë vetoje. Këtu nuk tentohet të thuhet pse tribunalet e lartpërmendura ushtarake penale (të Nürnbergut dhe Tokio-s) nuk kanë përndjekur dhe nuk kanë dënuar edhe amerikanët dhe rusët, por pse Serbia trajtohet në mënyrë tjetër dhe përndjekën dhe dënohen edhe luftëtarët e lirisë nga ana kroate, boshnjake dhe shqiptare. Sepse luftëtarë të lirisë kanë qenë në atë kohë edhe rusët dhe amerikanët.

Si nga ana e organeve qeveritare të Serbisë, ashtu edhe nga mediat e atjeshme sulmi i pikës policore në Dobrashin në

vitin 2012 u quajt si një sulm “terrorist” i shqiptarëve. Duke u bazuar nga ky këndvështrim parashtrohet pyetja se a mund të quhen si akte terroriste edhe sulmi dhe shkatërimi i pikave doganore dhe policore në Kosovë nga ana e serbëve? Apo si mund ta quajmë aktin e sulmit të familjes shqiptare në veri, ku nga një eksploziv i kurdisur në banesën e asaj familjeje u vra kryefamiljari dhe u plagosën anëtarët e tjerë të familjes, duke përfshirë edhe fëmijë? Nëse serbët i shohin këto sulme në atë këndvështrim, atëherë mund të themi me gjithë gojën se aktet e lartpërmendura serbe në Kosovë janë akte terroriste, të cilat duhet të vlerësohen, të përndjeken dhe të dënohen si të tilla.

3. ROLI I NDËRKOMBËTARËVE NË LUFTIMIN E KRIMINALITETIT SERB DHE VËNIES SË RENDIT DHE LIGJIT NË KOSOVË

UNMIK-u, i cili normalisht në vitin 2008 duhej të zëvendësohej nga EULEX-i dhe Përfaqësuesi Special i BE-së vazhdoi të ndjehet përgjegjës për Kosovën dhe fillimisht nuk mendoi në një transferim të kompetencave tek EULEX-i ose Qeveria e Kosovës.

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk çoi në trazira apo në “trazira katastrofale”, siç deklaroi Serbia dhe Rusia vazhdimisht para bashkësisë ndërkombëtare. Për t’i justifikuar këto pretendime, Serbia organizoi më 17 mars 2008, me ndihmën e shërbimit të vet sekret, ndër të tjera, sulmin dhe pushtimin e Gjykatës së Qarkut në pjesën veriore të Mitrovicës. Prej atëherë Gjykata nuk është më në duart e UNMIK-ut, i cili ishte përgjegjës për sigurinë dhe funksionimin e sistemit ligjor në pjesën veriore të Mitrovicës. Qeveria e Kosovës, e cila bëri thirrje për rivendosjen e sistemit juridik, është mbajtur çdo herë larg nga bashkësia ndërkombëtare. Vetëm më 17 shtator 2008 (shtatë muaj më vonë), zëdhënësi i UNMIK-ut, Aleksander Ivanko, tha se

UNMIK-u ka vendosur ta vërë përsëri në përdorim Gjykatën e Qarkut në pjesën veriore të Mitrovicës dhe shtoi se për sigurinë e kësaj gjykate është përgjegjëse vetëm policia. Pasi që kjo ndërtesë ishte demoluar nga serbët, ai tha se më 19 shtator 2008 do të fillojnë punën e rinovimit dhe pastrimit të zyrave të kësaj gjykate. Kurse emërimi i gjykatësve dhe i prokurorëve ndërkombëtarë do të bëhet në fillim të tetorit 2008,³² tha në atë kohë Ivanko. Në anën tjetër, po në të njëjtën ditë, komandanti i KFOR-it, gjenerali Gay, tha se KFOR-i është në dispozicion në qoftë se ftohet për bashkëpunim. Megjithatë, një kërkesë e tillë nuk është bërë³³. Më 20 shtator 2008 u bë e ditur se puna e rinovimit të Gjykatës nuk kishte ndodhur. Në pyetjen e televizionit publik RTK, zëdhënësi i UNMIK-ut, Svend Lindholm, tha se ai nuk ishte i informuar që puna e rinovimit nuk kishte filluar dhe se ai është “i habitur”³⁴ për këtë fakt. Pas deklaratës së komandantit të KFOR-it të 17 shtatorit 2008 pasoi një

³² Krahaso, Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më datën 17.9.2008 në ora 19:30.

³³ Krahaso, Gjenerali Gay, Komandanti i KFOR-it, në: Lajmet qendrore në RTK më datën 17.9.2008 në ora 19:30.

³⁴ Lindholm, Svend, në: Lajmet qendrore RTK më datën 20.9.2008 në ora 19:30.

deklaratë e re nga ana e zëdhënësit të UNMIK-ut, Aleksandër Ivanko, më 22 shtator 2008, ku thuhet se KFOR-i i kishte dorëzuar kontrollin e Gjykatës në Mitrovicën e Veriut UNMIK-ut dhe se puna e Gjykatës do të fillojë më 3 tetor 2008³⁵. Një ditë më vonë, zëdhënësi i UNMIK-ut, Ivanko, tha:

*“Në Veri nuk ka ligj. Ka shumë raste në gjykatë, njerëz në burg, por nuk e dinë sesa kohë ata do të qëndrojnë atje, sepse nuk ka vendime të gjykatës”.*³⁶

Më datën 24 shtator 2008 Ivanko deklaroi se “tani për tani” punën në Veri do ta fillojnë vetëm punonjësit e UNMIK-ut dhe jo edhe stafi vendor apo ai i EULEX-it³⁷. Me këtë ai vuri në pah balancën e kompetencave ndërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it si dhe rolin e institucioneve të vendit edhe shtatë muaj pas shpalljes së pavarësisë. Xhirimet e transmetuesit

³⁵ Krahaso, Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më datën 22.9.2008 në ora 19:30.

³⁶ Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më datën 23.9.2008 në ora 19:30.

³⁷ Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më datën 24.9.2008 në ora 19:30.

publik RTK, të cilat janë bërë brenda ndërtesës së gjykatës më 24 shtator 2008, kanë treguar jo vetëm shkatërrimin, por edhe kaosin dhe mungesën e dosjeve³⁸. Menjëherë pas kësaj zëdhënësi i UNMIK-ut, Ivanko, pa e bërë një ekzaminim të plotë tha që asnjë dosje nuk është larguar nga gjykata³⁹. Kryetari i Gjykatës së Qarkut në pjesën veriore të Mitrovicës, Kapllan Baruti, i raportoi RTK-së se atij i është thënë se në ditët e para të shkatërrimit të Gjykatës së Qarkut nga serbët ishin parë punonjësit e strukturave paralele, në prani të forcave të sigurisë serbe, duke i larguar dosjet nga gjykata. Ai tha se në ndërtesën e gjykatës ka pasur dosje, të cilat ishin kundër serbëve të përfshirë në krime lufte. Ai shtoi se si kryetar i gjykatës kishte kërkuar disa herë nga UNMIK-u dhe OSBE-ja ta vizitojë gjykatën, por ai nuk kishte marrë asnjë përgjigje⁴⁰.

Kryeministri i atëhershëm danez, Andreas Fogh Rasmussen, i cili sot është Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, gjatë vizitës

³⁸ Krahaso, Lajmet qendrore RTK më datën 24.9.2008 në ora 19:30.

³⁹ Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më 25.9.2008 në ora 19:30.

⁴⁰ Krahaso, Bruti, Kapllan, në: Lajmet qendrore RTK më datën 25.9.2008 në ora 19:30.

së tij në Kosovë më 18 shtator 2008 e kritikoi Serbinë për pengesat që po i bën EULEX-it gjatë punës së tij në Kosovë dhe theksoi se asnjë vendim nga OKB-ja nuk mund ta ndryshojë njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nga Danimarka, sepse kjo njohje është bërë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare⁴¹.

Zëdhënësi i UNMIK-ut në Mitrovicë, Georgy Kakuk, ishte zyrtari i parë i OKB-së i cili për gazetën amerikane “Chicago Herald Tribune” deklaroi lidhur me aktivitetet kriminale të serbëve në veri të Kosovës, përkatësisht në veri të Mitrovicës, si në vijim:

"Kontrabanda ndodh para syve të OKB-së dhe NATO-s. Kriminelët e kanë kuptuar se askush nuk do të ndërmarrë diçka kundër tyre."⁴²

Në anën tjetër, zëdhënësi i KFOR-it, kolonel Adriano Graziani, tha se KFOR-i është duke e bërë punën e vet. Më

⁴¹ Krahaso, Rasmussen, Andreas Fogh, ish-kryeministër i Danimarkës në lajmet qendrore RTK më datën 18.9.2008 në ora 19:30.

⁴² Lajmet qendrore në RTK më datën 29.9.2008, si më lart.

tutje ai tha se Policia e Kosovës dhe policia ndërkombëtare e bartin përgjegjësinë për të zbatuar ligjin.⁴³ Ndërsa ministri i Brendshëm serb, Ivica Daciq, në janar të vitit 2010 tha para nxënësve të shkollës së Mbrojtjes Popullore Serbe në Beograd se shqiptarët nga Kosova janë terroristë. Daciq ka qenë aktiv edhe në kohën e Slobodan Milosheviqit⁴⁴ duke shërbyer si zëdhënës i aparatit të atëhershëm kriminal shtetëror të Serbisë. Fatkeqësisht ai urrejtjen e tij kundër shqiptarëve e vazhdoi edhe pas kohës së Milosheviqit, duke e ndjekur politikën destruktive të ish-shefit të tij, Slobodan Milosheviq, kundër Kosovës.

Politikani aktual në Kosovë, Fuad Ramiqi, i cila ka qenë edhe ish-oficer i ushtrisë jugosllave dhe është veteran i luftës çlirimtare në Bosnjë dhe në Kosovë, theksoi se Kosova është ende në rrezik nga Serbia, për këtë arsye prania e NATO-s në Kosovë është ende me rëndësi jetike për Kosovën.⁴⁵

Edhe pse bashkësia ndërkombëtare tërë kohën pohonte se strukturat paralele serbe në Kosovë janë ilegale dhe nuk do të

⁴³ Krahaso, Graziani, Adriano, në: Lajmet qendrore të RTK-së më datën 9.9.2008 në ora 19:30.

⁴⁴ Koha Ditore: Dasic i kthehet fjalorit antishqiptar të Millosheviqit, Nr. 3744 të datës 27.1.2010, f. 2.

⁴⁵ Ramiqi, Fuad, ish-oficer ushtarak i Ushtrisë Jugosllave dhe politikan i tanishëm në Kosovë. Bisedë më datën 3.9.2010 në Prishtinë.

pranohen, më datën 18 mars 2009 RTK-ja (Televizioni Publik i Kosovës) deshmoi se si punonjësit e NATO-s dolën nga ndërtesa e “komunës” ilegale serbe të Kastriotit, ish-Obiliqit, pas një takimi që ata kishin pasur me kryetarin ilegal të asaj “komune”, Lubomir Bosanoviçin. Në të njëjtën ditë kryetari ilegal, Bosanoviç, deklaroi për RTK-në se ai ka takime të rregullta me KFOR-in dhe EULEX-in. Ai po ashtu deklaroi se ai së bashku me 30 punonjës kryen “tash e 8 muaj” shërbime komunale për serbët⁴⁶. Më 19 mars 2009 zëdhënësja e EULEX-it, Karin Limdal, deklaroi se EULEX-i ka kontakte të rregullta me përfaqësuesit e strukturave paralele, por se një gjë e tillë nuk do të thotë se ato struktura janë legalizuar⁴⁷. Veprimet e bashkësisë ndërkombëtare, posaçërisht të NATO-s dhe EULEX-it, që shumë herë patën deklaruar se nuk do t’i pranojnë strukturat paralele serbe, paraqisnin me këtë rast një kontradiktë në vetvete dhe një legalizim të këtyre strukturave. Këto struktura paralele me aktivitetin e tyre paraqesin një veprim ilegal dhe duhet të ndiqen edhe penalisht. Do të ishte njësoj sikur KFOR-i dhe

⁴⁶ Krahaso, Bosanac, Lubomir, në: Lajmet Qendrore të RTK-së më datën 18.3.2009 në ora 19:30.

⁴⁷ Krahaso, Limdal, Karin, në: Lajmet qendrore të RTK-së më datën 19.3.2009 në ora 19:30.

EULEX-i të takoheshin me strukturat e tjera kriminale (si p.sh. trafikantë droge, etj.), në vend se t’i luftojnë ato. Këto struktura ilegale nuk janë luftuar dhe nuk luftohen, por janë parë dhe janë trajtuar si problem politik, gjë që fatkeqësisht vazhdon edhe më tutje.

Veprimet e UNMIK-ut ishin që nga fillimi konfuzë. Ligjet, e veçanërisht ligji ndërkombëtar nuk u zbatua pothuajse fare në mënyrë të barabartë kur ishte fjala e trajtimit të popullatës shqiptare dhe asaj serbe. Në anën tjetër, u shfaq një trajtim jo i barabartë dhe diskriminues kur ishte fjala për të drejtat e popullit shqiptar dhe atij serb, duke i privilegjuar serbët në të gjitha fushat. Në luftimin e krimit në mesin e popullsisë serbe, UNMIK-u ishte që nga fillimi shumë i përmbajtur dhe nuk ishte i interesuar për të siguruar respektimin e ligjit.

Në një pritje të komandantit të ri të forcave të NATO-s për veriun e Kosovës, gjeneralit Philippe Brass, më 3 shkurt 2009, ish-kryetari i atëhershëm i Komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, i cili ishte më herët edhe Kryeministër i Kosovës dhe tani ministër i Punëve të Brendshme të Kosovës, tha që ishte koha të arrestohen kriminelët serbë në veri të Mitrovicës, të cilët përpiqen që ta destabilizojnë situatën. Ai

përmendi gjithashtu se rindërtimi i shtëpive shqiptare në veri të Mitrovicës u pengua në vitin 2008 në mënyrë të paligjshme nga ana e UNMIK-ut. "Banorët e komunitetit në Veri kanë dokumentacionin e nevojshëm për pronën e tyre dhe nuk kanë asnjë problem në këtë drejtim, për këtë arsye ata kanë nevojë për mbështetje për rindërtim dhe kjo nuk duhet të konsiderohet nga askush si një provokim."⁴⁸ Pasi që Bajram Rexhepi është ministër i Punëve të Brendshme të Kosovës, ai tani e ka mundësinë t' i përndjekë dhe t' i sjellë para drejtësisë edhe kriminelët serbë, qoftë edhe kundër dëshirës së dikujt nga bashkësia ndërkombëtare.

Fejzullah Hasani, i cili më 2 shkurt 2010 u emërua Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe që më parë ishte zëvendëskryetar i kësaj Gjykate, më 22 shkurt 2010 deklaroi se UNMIK-u është sjellë shumë keq dhe ka mbajtur njerëz me vite të tëra në paraburgim pa asnjë bazë ligjore, ku dhe

⁴⁸ Zëri i Ditës, Gazetë ditore: Rexhepi kërkon arrestimin e kriminelëve në veri të Mitrovicës, Nr. 2091, më datën 4.2.2009, f. 8.

pikëpamjet e gjykatësve vendor nuk kanë luajtur ndonjë rol për të.⁴⁹

Më 1 shkurt 2009 zëdhënësi i UNMIK-ut, Aleksander Ivanko, deklaroi se Policia, Gjyqësia dhe Doganat "tani janë çështje të EULEX-it"⁵⁰. Kreu i Departamentit të Drejtësisë në EULEX, Alberto Perdura, tha në një konferencë në Prishtinë më 23 janar 2009 se EULEX-i kishte marrë një trashëgimi të rëndësishme nga UNMIK-u në fushën e krimeve të luftës. Sipas tij, në janar 2009 ka pasur 50 raste për prokurorinë dhe rreth 1200 dosje të tjera për policinë, të cilët e kishin filluar punën e tyre. Ai tha se EULEX-i do të vazhdojë hetimet dhe do të sjellë secilin para drejtësisë në qoftë se ka prova të mjaftueshme për një gjë të tillë⁵¹. Në anën tjetër, ai deklaroi më 22 janar 2009 se Policia, Doganat dhe Gjyqësia janë nën mbikëqyrjen e EULEX-it dhe se EULEX-i do të ketë vetëm një rol këshilldhënës dhe jo vendimmarrës. Ai shtoi se Policia

⁴⁹ Hasani, Fejzullah, drejtor i Gjykatës Supreme të Kosovës, në: RTK-Programi i Mëngjesit „Mirëmëngjesi Kosovë“ më datën 22.2.2010 në ora 8:20.

⁵⁰ Krahaso, Ivanko, Alexander, në: Lajmet qendrore RTK më datën 1.2.2009 në ora 19:30.

⁵¹ Krahaso, Perduca, Alberto Perduca, në: Lajmet qendrore RTK më datën 23.1.2009 në ora 19:30.

e Kosovës mund të vendosë vetë se a dëshiron t'i pranojë rekomandimet e EULEX-it apo jo, pasi që ajo i merr vetë vendimet. Ai shtoi se në Shërbimin Policor të Kosovës do të angazhohen 450 anëtarë të policisë së Bashkimit Evropian⁵².

Ish-kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, i cili është edhe kryetar i Partisë Social-Demokrate të Kosovës dhe aktualisht ministër i Forcave të Sigurisë, deklaroi në fund të vitit 2008 se EULEX-i nuk është funksional dhe legjitim derisa ai nuk vepron në gjithë Kosovën. Ai tha:

“Unë propozoj që të mos njihet dhe respektohet EULEX-i për aq kohë sa ai nuk vepron në gjithë territorin e Kosovës”⁵³.

Më 25 shkurt 2009 kishte një konfuzion në sistemin e drejtësisë të Kosovës, pasi që gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën Supreme, Nobert Koster, shfuqizoi një vendim të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës dhe urdhëroi lirim të një grupi prej gjashtë njerëzish. Ai kishte vendosur në emër të

⁵² Krahaso, Lajmet qendrore RTK më datën 22.1.2009 në ora 19:30.

⁵³ Krahaso, Çeku, Agim, në: Lajmet qendrore RTK më datën 23.10.2008 në ora 19:30.

Gjykatës Supreme dhe kishte përdorur edhe vulën e saj. Ky vendim ishte marrë jo vetëm pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve vendor, por ishte i panjohur edhe për kryetarin e atëhershëm të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rexhep Haxhimusa. Ai tha se këtë e kishte kuptuar nëpërmjet mediave⁵⁴. Për këtë çështje zëdhënësja e Departamentit të Drejtësisë së EULEX-it, Kristina Herod, tha se qëllimi kryesor i EULEX-it është këshillimi dhe vëzhgimi, por se ai ka gjithashtu edhe pushtet ekzekutiv, nëse është fjala për “krime të rënda, si p.sh. trafikim njerëzor, pastrim parash, etj.”⁵⁵

Një iritim tjetër ndodhi më 3 mars 2009, kur EULEX-i e kishte informuar një banor të fshatit Krushë e Vogël se ai është akuzuar për një incident të 25 majit 2006. Krusha e Vogël është një nga fshatrat ku gjatë luftës 1998-1999 serbët kanë ndarë burrat nga gratë dhe i kanë pushkatuar rreth 100 fshatarë shqiptarë. Pavarësisht kësaj masakre, më 25 maj 2006 UNMIK-u, me rreth 20 makina të UNMIK-ut, shkoi në fshat me ish-fshatarë serbë, pa i njoftuar paraprakisht banorët e fshatit. Trazirat kishin ndodhur për arsye se në makinat e

⁵⁴ Krahaso, Haxhimusa, Rexhep, në: Lajmet qendrore RTK më datën 25.2.2009 në ora 19:30.

⁵⁵ Krahaso, Herodes, Kristina, në: Lajmet qendrore RTK më datën 25.2.2009 në ora 19:30.

UNMIK-ut ishin parë ish-fshatarët serbë që kishin kryer krime gjatë luftës kundër fshatarëve shqiptarë. Pati trazira në të cilat nga Policia e UNMIK-ut u plagosën gjithsej 37 fshatarë shqiptarë, duke përfshirë 34 gra që u trajtuan në spitalin e Prizrenit. Në atë kohë përfaqësuesit e Policisë së UNMIK-ut deklaruan se do të ndërmarrin masa kundër këtyre policëve të UNMIK-ut.⁵⁶ Kryetari i Shoqatës për Hulumtimin e Personave të Rrëmbyer të 26 marsit 1999, Agron Limani, tha: “Ne jemi të bindur se UNMIK-u ka punuar vazhdimisht kundër interesave tona, por ne kemi dashur të besojmë se EULEX-i nuk do ta ndjekë rrugën e UNMIK-ut, por për fat të keq kjo po ndodh për shkak se zyrtarët e UNMIK-ut vazhdojnë të punojnë në EULEX, gjë që përputhet me fjalën popullore se ‘ujku qimen e ndërron, por zakonin nuk e harron’.”⁵⁷

Neni 8, paragrafi 9 i Konferencës së Përbashkët 2008/124⁵⁸ përcakton se shefi i Misionit ka për të siguruar që EULEX-i

⁵⁶ Krahaso, EULEX-i provokon në plagë të hapura, në: Infopress, Nr. 871 më datën 6.3.2009, f. 8.

⁵⁷ Eulex-i provokon në plagë të hapura, në: Infopress, Nr. 871, më datën 6.3.2009, f. 8.

⁵⁸ Gemeinsame Aktion 2008/124/GASP des Rates vom 4. Februar 2008 über die Rechtsstaatlichkeitsmission der Europäischen Union im

të bashkëpunojë ngushtë dhe të koordinojë punën e tij “me autoritetet kompetente të Kosovës...”

Më 6 shkurt 2010, në televizionin e vetëm publik të Kosovës u shfaq në lajmet kryesore si gazetarët e këtij programi u ndaluan në xhirimet e tyre nga ana e Policisë së EULEX-it në pikën kufitare “Gazivodë”, në veri të Kosovës, edhe pse gazetarëve të RTK-së iu ishte dhënë leja për xhirim nga Policia e Kosovës. U tregua se si një polic i EULEX-it komentoj se leja e Policisë së Kosovës për të xhiruar “nuk është e vlefshme” dhe se një miratim i tillë duhet të merret nga EULEX-i.⁵⁹ Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Hasani, tha më 22 shkurt 2010 se “EULEX-i, të paktën deri më tani, për dallim nga UNMIK-u, sillet në mënyrë profesionale dhe gjithashtu merr parasysh mendimet e gjyqtarëve vendor”.⁶⁰ Në anën tjetër, kreu i atëhershëm i Policisë Kufitare të Kosovës, gjeneral Behar Selimi, i

Kosovo, EULEX KOSOVO, ABL. L 42/92 vom 16.2.2008 (Plani i Përbashkët 2008/124/GASP i Këshillit të 4 shkurtit 2008 mbi Krijimin e misionit e drejtësisë të Unionit Evropian në Kosovë, EULEX KOSOVE të datës 16.2.2008), f. 4.

⁵⁹ RTK-Lajmet qendrore më datën 6.2.2010 në ora 19:30.

⁶⁰ Fejzullah Hasani, kryetari i Gjykatës Supreme, në: Programin e Mëngjesit në RTK “Mirëmëngjesi Kosovë” më datën 22.2.2010 në ora 8:00.

përshkroi marrëdhëniet me EULEX-in si shumë më të mira se ato me UNMIK-un, për shkak se Policia e Kosovës konsiderohet nga misioni i EULEX-it si një “organizatë me kompetenca të plota”⁶¹, me përjashtim të punonjësve të EULEX-it, të cilët më herët kanë shërbyer në misionin e UNMIK-ut dhe që “sillen si në kohët e vjetra dhe nuk e pranojnë lehtë mandatin tonë”.⁶²

⁶¹ Selimi, Behar, ish Drejtor i Pergjithshem i Policise se Kosoves. Bisedë më datën 12.3.2010 në Prishtinë.

⁶² Po aty.

4. PËRMBLEDHJE

Ish-presidenti finlandez, Martti Ahtisaari, u emërua Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të dhënë një rekomandim për statusin e ardhshëm të Kosovës. Pas dorëzimit të këtij rekomandimi më datën 2 shkurt 2007 si dhe versionit të përpunuar të datës 26 mars 2007, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së me letër të 26 marsit 2007 ia dorëzoi këtë Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ky rekomandim nuk u pranua nga Serbia, kështu që u refuzua automatikisht në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nga aleatja e Serbisë, Rusia. Ky rekomandim, pra, nuk u miratua në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nëpërmjet një rezolute, kështu që ajo nuk paraqet ndonjë bazë ligjore ndërkombëtare apo ndonjë detyrim për ndonjë palë. Është diçka tjetër që pala shqiptare e pranoi këtë rekomandim dhe i dha atij edhe bazën ligjore, i cili e detyron vetëm atë dhe jo edhe anën e kundërt. Ky rekomandim i dha të drejta pakicës serbe si në asnjë vend tjetër të botës dhe nëpërmes këtyre të drejtave të tepruara u synua që këtë rekomandim ta pranojnë edhe Serbia dhe aleatet e saj, si p.sh. Rusia dhe Kina. Prandaj institucionet e Kosovës nuk është dashur t'i japin atij rekomandimi edhe formën ligjore, por t'i pranojnë vetëm

kushtet të cilat janë normale dhe praktikohen edhe në botën perëndimore, dhe jo edhe kushtet të cilat janë shpikje të reja dhe eksperimente të rrezikshme. Institucionet e Republikës së Kosovës e detyruan veten edhe me Deklaratën e Pavarësisë dhe me Kushtetutë për zbatimin e plotë të rekomandimeve të Ahtisaarit, edhe pse ky rekomandim nuk parashikoi një pavarësi të vërtetë të Kosovës, meqë prania ndërkombëtarëve vazhdon të ketë pushtet ekzekutiv dhe, si rrjedhojë, shkilet si sovraniteti, ashtu edhe integriteti i Republikës së Kosovës.

Gabimet e vitit 1999 u përsëritën. Në atë kohë Serbia nuk e pranoi Marrëveshjen e Rambujesë, edhe pse kjo marrëveshje e kishte për synim edhe parandalimin e një intervenimi ushtarak kundër Serbisë dhe Malit të Zi dhe Kosovës i ofronte vetëm një autonomi të zgjeruar. Serbia në atë kohë e refuzoi këtë marrëveshje, gjë që NATO-ja e sulmoi Serbinë dhe Malin e Zi ushtarakisht dhe i dëboi nga Kosova forcat ushtarake serbo-malazeze. Edhe pse Marrëveshja e Rambujesë ishte një formulim para intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë dhe kishte për qëllim pranimin e saj nga ana e Serbisë, kjo marrëveshje u përdor nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së pothuajse në të njëjtën formë në Rezolutën 1244 të 10 qershorit 1999, e cila e vuri Kosovën

nën administrimin e OKB-së. Ky veprim ishte i gabuar, pasi që teksti i Marrëveshjes së Rambujesë ishte me refuzimin e tij nga Serbia dhe ndërhyrjen ushtarake të NATO-s i tejkaluar. OKB-ja themeloi një mision dhe përpiloi Rezolutën 1244, në atë mënyrë që të mos të ketë ndonjë rezolutë të re, pa pëlqimin e Rusisë dhe Kinës. Sepse aty thuhet se kjo Rezolutë mund të ndryshohet apo të shfuqizohet vetëm nëpërmes një Rezolutive të re të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, gjë e cila është e pamundur, nëse me një gjë të tillë nuk është e pajtimit edhe Serbia, e cila në krahun e saj në OKB e ka Rusinë dhe Kinën me të drejtë vetoje.

Pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare, si Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe shumica e vendeve të BE-së u deklaruan pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, u angazhuan për implementimin e rekomandimeve të Ahtisaarit dhe funksionimin e pavarësisë. Njëkohësisht ata i dhanë një rëndësi të veçantë çështjeve që u përkasin “serbëve” (decentralizimit, themelimit të komunave në enklavat serbe dhe të drejtave të pakicave), të cilat janë duke u zbatuar plotësisht, gjë që rezultoi me mosimplementimin e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës në tërë territorin. Në këtë mënyrë nuk u ndërmorën hapa seriozë në lidhje me vendosjen

e sovranitetit dhe të integritetit të plotë territorial të Republikës së Kosovës. Serbia vazhdon, pra, të ketë struktura ilegale paralele në Kosovë dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës në veri të Mitrovicës nuk janë ende nën komandën e drejtpërdrejtë të Policisë së Kosovës. Kryetari i Komisionit Parlamentar të Kosovës për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Ismet Beqiri, e konfirmoi se “serbët në Kosovë kanë të drejta si në asnjë vend tjetër të botës, kështu që mund të flasim për një diskriminim pozitiv, kur bëhet fjalë për të drejtat dhe privilegjet e pakicës serbe në Kosovë”.⁶³ Një gjë të tillë fatkeqësisht nuk e gëzon pakica shqiptare në Serbi, ku partitë shqiptare janë të detyruara ta ndajnë mes vete një mandat të vetëm të deputetit në parlamentin e Serbisë.

Në anën tjetër, askush nuk mund t’ i krahasojë strukturat paralele shqiptare të cilat kanë ekzistuar në Kosovë prej vitit 1991 deri në vitin 1999 nën udhëheqjen e ish-presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova me ato të Serbisë në Kosovë, të cilat u krijuan në Kosovë pas vitit 1999. Strukturat e

⁶³ Beqiri, Ismet, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Bisedë më datën 9.3.2010 në Prishtinë.

atëhershme paralele të shqiptarëve të Kosovës nuk e kanë uzurpuar asnjë ndërtesë apo institucion shtetëror dhe nuk e kanë penguar shtrirjen apo funksionimin e pushtetit serb në Kosovë. Të gjitha institucionet shtetërore kanë mundur pra ta kryejnë punën e tyre pa asnjë pengesë dhe e kanë shtrirë funksionin e tyre në çdo cep të Kosovës. Për shtetin serb atë kohë fakti i zhvillimeve të mësimave në gjuhën shqipe nëpër bodrume apo shtëpi private ka qenë i parëndësishëm dhe nuk ka paraqitur kurrfarë pengese për ta. Ai fakt ata vetëm se i ka kënaqur dhe i ka ndihmuar, pasi që ata jo vetëm se nuk i kanë njohur diplomat e tyre, por në Kosovë u hapën vende të reja pune dhe Kosova u bë një vend atraktiv dhe tërheqës për serbët e papunë dhe refugjatët serbë nga Kroacia dhe Bosnja, shumica e të cilëve jetojnë sot ende nëpër enklavat serbe në Kosovë. Në anën tjetër, shqiptarët në atë kohë nuk kanë bllokuar as rrugët siç e bëjnë serbët sot dhe strukturat e tyre kanë kontribuar në përmbajtjen dhe mosrezistimin e armatosur të shqiptarëve kundër dhunës së atëhershme serbe. Në atë kohë pjesëtarët e institucioneve paralele të shqiptarëve kanë qenë të detyruar ta lëshojnë Kosovën dhe ato kanë ekzistuar de fakto vetëm në Perëndim, gjë që nuk kanë paraqitur kurrfarë rreziku për Serbinë. Personat të cilët e kanë quajtur veten pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme

apo të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës janë përndjekur nga Serbia dhe janë futur nëpër burgje. Pra, strukturat e atëhershme shqiptare nuk mund të krahasohen me ato të sotme të serbëve, të cilat paraqesin një kërcënim të drejtpërdrejtë të paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe janë një kërcënim serioz për shtetin e Kosovës. Ky elaborim bëhet për shkak se ka pasur disa tentativa nga persona të ndryshëm që strukturat paralele-ilegale serbe të mos merren seriozisht, duke u thirrur edhe në ish-strukturat e lartpërmendura paralele shqiptare të viteve të 90-ta.

Nuk duhet harruar fakti se në botën perëndimore struktura të tilla ilegale do të ishin luftuar dhe asgjësuar menjëherë dhe kundër bllokimeve të tilla të rrugëve do të ishte vepruar në mënyrën më të ashpër të mundshme për lirimin e tyre. Shembullin më të mirë e kemi Francën, e cila kampet e romëve i asgjësoi edhe më dhunë, kurse të njëjtën gjë e bëri edhe Gjermania çdo herë kundër përpjekjeve të demonstruesve gjermanë, të cilët tentojnë ta bllokojnë transportimin e kastorëve bërthamorë apo për shpërndarjen e demonstratave jopaqësore. Veprimi i fundit i forcave të KFOR-it për zhbllokimin e rrugës Zveçan-Rudar është një veprim i qëlluar dhe një gjë të tillë duhet ta bëjë në gjithë

territorin e Kosovës. Sesa të rrezikshme janë strukturat ilegale serbe dhe se ato duhet të luftohen me seriozitetin më të madh, qoftë edhe me forcë, e dëshmon edhe fakti ku gjatë tentimit të zhbllokimit të rrugës së lartëpërmendur ushtarët e KFOR-it më datën 1 qershor 2012 u sulmuan prapë nga serbët edhe me armë zjarri, ku pati edhe të plagosur. Por, as KFOR-i dhe as organizmat e tjerë ndërkombëtar, duke e përfshirë edhe qeverinë e Kosovës, nuk duhet të dorëzohen para strukturave ilegale serbe dhe kriminelëve të tjerë serbë, të cilët janë të koncentruar nëpër enklavat serbe dhe e rrezikojnë seriozisht paqen dhe sigurinë në vend dhe paraqesin rrezik potencial për Kosovën dhe qytetarët e saj, sidomos ata shqiptarë.

Si përfundim mund të thuhet:

Bashkësia ndërkombëtare ka mundësuar, ka lejuar dhe ka toleruar krijimin dhe funksionimin e strukturave paralele-ilegale serbe në Kosovë, duke kontribuar në mënyrë parciale në destabilizimin e Kosovës. Kurse, në anën tjetër, institucionet e Kosovës shumë herë e kanë respektuar bashkësinë ndërkombëtare së tepërmi, posaçërisht kur kemi pasur

të bëjmë me kërkesat e njëanshme të minoritetit serb apo siç ishte edhe rasti i ndikimit ndërkombëtar për shkarkimin e ish-kryetarit të Parlamentit, Nexhat Deaci dhe të ish-kryeministrit Bajram Kosumi në vitin 2006.

Kurse është më se e nevojshme që

strukturat paralele serbe, të cilat janë ilegale dhe në kundërshtim me të gjitha normat si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, duhet të shuhen qoftë edhe nëpërmjet përdorimit të forcës. Institucionet e Kosovës duhet të përkrahen në shuarjen e këtyre strukturave dhe shtrirjen e pushtetit edhe në ato pjesë dhe jo të pengohen. Pasi që bashkësia ndërkombëtare nuk është e interesuar në shtrirjen e rendit dhe ligjit edhe nëpër enklavat serbe, pavarësisht deklarimeve të ndryshme kozmetike të saj, qeveria e Kosovës duhet ta bëjë një gjë të tillë vetë me shfrytëzimin e kapacitetit të Policisë dhe Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës. Por, duke mos u tërhiqur prapa si herën e fundit.

Në anën tjetër

mbajtja e zgjedhjeve serbe në Kosovë duhet jo vetëm të mos përkrahet më, por edhe të ndalohet qoftë edhe me forcë. Organizimi i këtyre zgjedhjeve në Kosovë, sidomos përkrahja e tyre nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe organizimi i tyre nga OSBE-ja, është e patolerueshme dhe nuk duhet të lejohet prapë. Bashkësia ndërkombëtare një gjë të tillë nuk e ka bërë asnjëherë në territorin e Serbisë, Malit të Zi apo Maqedonisë, kur kemi të bëjmë me shqiptarët. Përkundrazi, edhe gjatë kohës së UNMIK-ut, do të thotë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku në përgjithësi përgjegjës kanë qenë ndërkombëtarët, ka pasur për shqiptarët të cilët kanë jetuar jashtë territorit të Kosovës vetëm pengesa për të votuar, ndër të tjera duke i kushtëzuar me kohën e qëndrimit të fundit në Kosovë, gjë që ishte mu koha e largimit të detyruar të shqiptarëve nga Kosova dhe ardhja e serbëve në Kosovë nga Serbia, Kroacia dhe Bosnja.

Institucionet ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë

nuk duhet të lejojnë t'i lirojnë kriminelët serbë pas kërcënimeve të ndryshme serbe, siç ishte rasti i fundit me Jovica Milkoviq, i cili ishte arrestuar më 17 maj 2012 dhe u lirua nga EULEX më datën 26 maj 2012⁶⁴, pasi që një grup demonstruesish serbë në veri të Mitrovicës më datën 25 maj 2012 kërcënuan me "hapa më radikalë" nëse kriminelin Milkoviq, i cili kishte shkatërruar kontejnerin e policisë dhe kishte penguar policinë në kryerjen e detyrës, nuk do të lirohej deri më datën 28 maj 2012⁶⁵.

⁶⁴ Krahaso, EULEX-liron Milkoviqin e dyshimtë për shkatërrimin e kontejnerit të policisë, <http://www.koha.net/arkiva/index.php?page=1,13,100970>, qasur më datën 26.5.2012. Shih po ashtu në [http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61051&mfo3n-Mwmd3g7!70ZC\)xAOi\\$66i!5n=07izZ&+\)8d6e5W8zffweddm&pmsze#Z15dx82!lm&0cCi8w8xm6d^^P00!z&8-6cY&dm1cF](http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61051&mfo3n-Mwmd3g7!70ZC)xAOi$66i!5n=07izZ&+)8d6e5W8zffweddm&pmsze#Z15dx82!lm&0cCi8w8xm6d^^P00!z&8-6cY&dm1cF), qasur më datën 26.5.2012.

⁶⁵ Serbët paralajmërojnë "hapa radikalë", në: http://www.koha.net/arkiva/index.php?page=1,13,100848&s=&f_d=2012-05-25&t_d=2012-05-26&ch=13,31,14,15,16,3,4,5,10,9,18,19,20,21,6,7,8, qasur më datën 25.5.2012. Shih edhe në <http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61009>, qasur më datën 25.5.2012.

Betimi i presidentit të ri të Serbisë, Tomislav Nikoliq, me fjalët

“Betohe se të gjitha forcat e mia do t’ia përkushtoj ruajtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Serbisë, përfshirë edhe Kosovën, si pjesë përbërëse të saj”⁶⁶

dëshmon edhe një herë se Kosova është e kërcënuar nga Serbia dhe se një shtet i cili kërcënon ekzistencën e një shteti tjetër duhet të konsiderohet si shtet armik dhe me të nuk duhet të bisedohet për asnjë çështje tjetër pa u rregulluar së pari çështja e pretendimit territorial dhe heqja dorë nga kërcënimet e tilla. Irani, i cili nuk e njeh shtetin e Izraelit dhe e kërcënon atë shihet nga Izraeli dhe bota perëndimore si një rrezik potencial për shtetin izrealit dhe të gjithë ne jemi dëshmitarë të reagimeve izrealite dhe perëndimore. Prandaj, nuk mund të bisedosh me Serbinë për lule, kur ajo të drejton

⁶⁶ Presidenti serb, Tomislav Nikoliq, bën betimin, në:
<http://www.koha.net/?page=1,15,101634>, qasur më datën 1.6.2012.

armën. Para se të bisedohet me Serbinë për çështje të tjera, Serbia duhet që

1. të kërkojë falje për krimet e bëra nga serbët kundër popullit shqiptar të Kosovës;
2. të tërheqë strukturat e saja ilegale serbe nga Kosova;
3. të njohë sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës, të shpallur më 17 shkurt 2008;
4. të kontribuojë në zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të zhdukur gjatë luftës në Kosovë;
5. të paguajë dëmin e luftës të shkaktuar Kosovës dhe popullit shqiptar;
6. t’i kthejë Kosovës shërbimet pensionale dhe sociale të paguara nga qytetarët e Kosovës para vitit 1999 dhe
7. të heqë dorë nga provokimet dhe përzierja e mëtutjeshme në punët e brendshme të Republikës së Kosovës.

Pas plotësimit të këtyre 7 pikave edhe mund të zhvillohen bisedime dhe të lidhen marrëveshje që kanë të bëjnë me çështje të tjera, por si dy shtete të pavarura dhe sovrane.

Se kështu duhet vepruar e di edhe bashkësia ndërkombëtare, sepse edhe ata kanë vepruar dhe do të vepronin prapë në këtë mënyrë. Prandaj, nuk është mirë që ndërkombëtarët t'iu thonë shqiptarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës bëni çfarë ju themi ne, por mos bëni çfarë bëjmë apo do të bënim ne!

5. LITERATURA

Rasmussen, Andreas Fogh, ish-kryeministër i Danimarkës, në lajmet qendrore RTK më datën 18.9.2008 në orën 19:30.

Arnold, Pascal (Hrsg.): Der UNO- Sicherheitsrat und die strafrechtliche Verfolgung von Individuen: die ad-hoc Tribunale zur Verfolgung von Kriegsverbrechen im ehemaligen Jugoslawien und in Ruanda sowie das Statut des Internationalen Strafgerichtshofs (Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe ndjekja penale e individëve: Tribunali ad hoc për përndjekjen e kriminelëve të luftës në ish-Jugosllavi, Ruandë si dhe Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar Penal), Institut du Federalisme Fribourg, Suisse.- Basel: Genf, München: Helbing und Lichtenhahn 1999.

Baruti, Kapllan, në: Lajmet qendrore RTK më datën 25.9.2008 në ora 19:30.

Beqiri, Ismet, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione: Bisedë më datën 9.3.2010 në Prishtinë.

Bisedë me zyrtarin e Policisë së Kosovës X-4 në Prishtinë më datën 18.5.2009.

Bosanac, Lubomir, në: Lajmet qendrore të RTK-së më datën 18.3.2009 në ora 19:30.

Çeku, Agim, në: Lajmet qendrore RTK më datën 23.10.2008 në ora 19:30.

Der Fischer Weltalmanach 2000 (Hrsg.): Zahlen, Daten, Fakten (Almanahu botëror 2000 i Fischer-it: Shifrat, Të dhënat, argumentet). Fischer Taschenbuch Verlag GmbH, Frankfurt am Main 1999.

Express, Nr. 1170, më datën 31.5.2008. Flakaresha për Gjeneralin.

EULEX-i provokon në plagë të hapura, në Infopress, Nr. 871 më datën 6.3.2009.

EULEX-liron Milkoviqin e dyshimtë për shkatërrimin e kontejnerit të policisë, <http://www.koha.net/arkiva/index.php?page=1,13,100970>,

qasur më datën 26.5.2012. Shif po ashtu në [http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61051&mfo3n-Mwmd3g7!70ZC\)xA0i\\$66i!5n=07izZ&+\)8d6e5W8zffwedd m&pmsze#Z15dx82!lm&0cCi8w8xm6d^^P00!z&8-6cY&dm1cF](http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61051&mfo3n-Mwmd3g7!70ZC)xA0i$66i!5n=07izZ&+)8d6e5W8zffwedd m&pmsze#Z15dx82!lm&0cCi8w8xm6d^^P00!z&8-6cY&dm1cF), qasur më datën 26.5.2012.

Fejzullah Hasani, kryetar i Gjykatës Supreme, në: Programin e Mëngjesit në RTK “Mirëmëngjesi Kosovë” më datën 22.2.2010 në ora 8:00.

Frankfurter Allgemeine Zeitung më datën 22.11.1997.

Gemeinsame Aktion 2008/124/GASP des Rates vom 4. Februar 2008 über die Rechtsstaatlichkeitsmission der Europäischen Union im Kosovo, EULEX KOSOVO, ABL. L 42/92 vom 16.2.2008 (Plani i Përbashkët 2008/124/GASP i Këshillit të 4 shkurtit 2008 mbi Krijimin e misionit e drejtësisë të Unionit Evropian në Kosovë, EULEX KOSOVË më datën 16.2.2008).

Gjenerali Gay, Komandant i KFOR-it, në: Lajmet qendrore në RTK, 19:30 më datën 17.9.2008. www.rtklive.com/Lajmet_qendrore/17/09/08.

Graziani, Adriano, në: Lajmet qendrore të RTK-së më datën 9.9.2008 në ora 19:30.

Hasani, Fejzullah, drejtor i Gjykatës Supreme të Kosovës, në RTK- Programi i Mëngjesit „Mirëmëngjesi Kosovë“ më datën 22.2.2010 në ora 8:20.

Haxhimusa, Rexhep, në Lajmet qendrore RTK më datën 25.2.2009 në ora 19:30

Herodes, Kristina , në Lajmet qendrore RTK më datën 25.2.09 në ora 19:30.

http://www.rp-online.de/politik/ausland/Deutschland-uebernimmt-Kommando-ueber-Nato-Truppen_aid_755181.html, qasur më datën 19.2.2010.

<http://www.rtklive.com/new/>, qasur më datën 19.2.1010, si dhe: RTK-Lajmet e Mëngjesit: “Mirëmëngjesi Kosovë” më datën 19.2.2010 në ora 8:00.

International Criminal Tribunal for Ex-Yugoslavia: Status of Cases,

http://www.icty.org/x/file/Cases/keyfigures/key_figures_120302_en.pdf, qasur më datën 20.5.2012.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 22.9.2008 në ora 19:30.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 23.9.2008 në orën 19:30.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 24.9.2008 në orën 19:30.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 1.2.2009 në ora 19:30.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 17.9.2008 në ora 19:30.

Ivanko, Alexander, në Lajmet qendrore RTK më datën 25.9.2008 në ora 19:30.

Jeremic: Tri prioritete të luftës për Kosovën, në: <http://www.rtklive.com/new/?cid=news>, qasur më datën 18.2.2010.

Koha Ditore: Dasiq i kthehet fjalorit antishqiptar të Millosheviqit, Nr. 3744 of 27.1.2010.

Koha Ditore, Nr. 3937 më datën 31.05.08. "Qeveria nuk lejon suspendimin pa pagesë të policëve serbë".

Krasniqi, Mark: Kosova heute: Referat vor dem belgischen Senat am 15. Okt. 1992 (Kosova sot: Referat para Senatit belg më 15 tetor 1992), Prishtina 1992. Aus dem Albanischen übersetzt von Hans-Joachim Lanksch. Hrsg.: E. Nujici, 1. Aufl., Frankfurt/Main: Wernicke 1997.

Lajm, e përditshme informative, Nr. 1129, më datën 31.05.2008. Vendime brenda dite.

Lajmet qendrore RTK më datën 24.9.2008 në ora 19:30.

Lajmet qendrore RTK më datën 22.1.2009 në ora 19:30.

Lindholm, Svend, në Lajmet qendrore RTK, 19:30 më datën 20.9.2008, www.rtklive.com/Lajmet_qendrore/20/09/08.

Limdal, Karin, në Lajmet qendrore të RTK-së më datën 19.3.2009 në ora 19:30.

Ministria e Punëve të Brendshme: Shumica e policëve serbë të suspenduar u rikthyen në Policinë e Kosovës, Prishtinë, 1.8.2009, <http://www.mp-ks.org/?page=1,46,291>, qasur më datën 1.8.2009.

Perduca , Alberto Perduca, në Lajmet qendrore RTK më datën 23.1.2009 në ora 19:30.

Presidenti serb Tomislav Nikoliq bën betimin, në: <http://www.koha.net/?page=1,15,101634>, qasur më datën 1.6.2012.

Ramiqi, Fuad, ish-zyrtar ushtarak i Ushtrisë Jugosllave dhe politikan i tanishëm në Kosovë. Bisedë më datën 3.9.2010 në Prishtinë.

Rugova, Mujë: Beistand von serbischen Intellektuellen (Përkrahja e intelektualëve serbë), në RTK-Lajmet qendrore më datën 6.2.2010 në ora 19:30.

Sejdiu, Fatmir, në Lajmet qendrore në RTK më datën 29.9.2008 në ora 19:30, [www.rtklive.com/lajmet_qendrore më datën 29.9.2008](http://www.rtklive.com/lajmet_qendrore_më_datën_29.9.2008).

Serbien fühlt sich von UN-Tribunal „vergewaltigt“ (Serbia e ndien veten të „përdhunuar“), në: Die Welt më datën 28.2.2009.

Serbët paralajmërojnë "hapa radikalë", në: http://www.koha.net/arkiva/index.php?page=1,13,100848&s=&f_d=2012-05-25&t_d=2012-05-26&ch=13,31,14,15,16,3,4,5,10,9,18,19,20,21,6,7,8, qasur më datën 25.5.2012. Shih edhe në <http://www.rtklive.com/?cid=1&newsId=61009>, qasur më datën 25.5.2012.

Selimi, Behar, ish-drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Bisedë më datën 12.3.2010 në Prishtinë.

Simic, Ziran: Zyrtar serb i Policisë së Kosovës, në RTK-Lajmet Qendrore më datën 29.6.2009 në ora 19:30.

Sopjani, Enver: Military Policies and Policing in Kosova since 1999: The Role of the International Community. Berlin, LIT Verlag 2011.

The mission of the National Olympic Committees (NOCs) is to develop, promote and protect the Olympic Movement in their respective countries, <http://www.olympic.org/ioc-governance-national-olympic-committees>.

Trajkovic, Rada, në Lajmet qendrore të RTK-së më datën 29.9.2008 në ora 19:30.

Zëri i Ditës, Gazetë ditore: Rexhepi kërkon arrestimin e kriminelëve në veri të Mitrovicës, Nr. 2091, më datën 4.2.2009.

Zëri i Ditës, Gazetë ditore: Serbët pengojnë vizitën e Ahmetit dhe Kuehenit në stationet policore në veri, Nr. 2816, më datën 6.3.2009.

6. SHKURTESAT

| | |
|--------------|---|
| BE | Bashkimi Evropjan |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë |
| KFOR | Forcat e Kosovës (të NATO-s) |
| NATO | Organizata Veriatlantike |
| OKB | Organizata e Kombëve të Bashkuara |
| OSBE | Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë |
| RTK | Radio Televizioni i Kosovës |
| UNMIK | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë |

Pjesa e dytë

M.Sc. Naser Sopjani, PhD cand.

QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. HYRJE

Republika e Kosovës si shteti më i ri në botë, i krijuar pas shumë e shumë shekujsh ekzistence, me prejardhjen e saj të lashtë ilire, tanimë në gjirin e vet ka edhe minoritete. Megjithëse territori i saj i tanishëm është i vogël, larmia e popullsisë së saj është e madhe. Ajo në gjirin e vet ka turq, goranë, ashkalinj, serbë, egjiptianë, kroatë, etj., e ndër pakicat më së shumti ka serbë.

Kjo popullatë në Kosovë ka ardhur në periudha të ndryshme, kryesisht dhe më së shumti pas largimit të Perandorisë Osmane, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, pastaj në vitet në vazhdim 1913, 1914 e tutje, ku u bë edhe aneksimi i tokave shqiptare, Kosovës në këtë rast, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Në këto periudha të gjata kolonizimi me serbë i tokës shqiptare ndryshoi edhe gjeografinë e popullsisë në Kosovë.

Tani me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, minoritetit serb i janë garantuar të gjitha të drejtat e tij maksimale që mund t'i ketë ndonjë minoritet në botë. Të drejtat e tyre janë aq të mëdha sa në një farë mase ndjehet e diskriminuar edhe popullata shumicë, shqiptarët, e lërë me minoritetet e tjera që janë pothuaj njëjtë me numër si serbët.

Institucionet e Kosovës i kanë hapur dyert dhe u kanë rezervuar vende në çdo skutë institucionale.

Prapëseprapë, kjo gjë minoritetin serb nuk është duke e kënaqur, ku dëshira e të qenit i pari po i verbon, e inkuadrimi i tyre në institucione është shumë formal, sa për të marrë beneficione të dyfishta, kurse kontributi i tyre për institucionet e Republikës së Kosovës është minimal.

Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme për ta trajtuar është ajo se minoriteti serb pavarësisht asaj se i janë afruar të gjitha mundësitë për jetë të mirë në Kosovës, ai prapëseprapë tregon jogatishmërinë e duhur për të dhënë kontribut si çdo pakicë tjetër në botë. Çdo shtet në botë në vete ka minoritete, edhe Kosova ka minoritete dhe faktin se serbët mund të jenë edhe pakicë në ndonjë shtet, ata nuk janë duke e kuptuar siç duhet.

E tërë bota, në fakt, është duke e kuptuar këtë situatë, por loja e tyre e padrejtë ndaj Republikës së Kosovës, duke u sjellë si padronë të Kosovës, duke menduar se çdoherë duhet qenë servilë ndaj tyre, duke iu falënderuar ditë e natë, është duke i sjellë dëm të pamasë Kosovës.

Të gjithë e dinë dhe e dimë se minoriteti serb është i lazdruar tej mase dhe politika serbe është shumë aktive në Evropë, kurse minoriteti serb në Kosovë është veçse vegël e tyre.

Minoriteti serb në institucionet e Kosovës është futur dhe nga aty del dhe bojkoton sa herë të dojë, pa pasur asnjë pasojë për ato veprime, del e bën veprime kriminale e prapëseprapë i pakënaqur.

Veprimet e tyre janë shumë të çuditshme, si në raport me të tjerët, ashtu edhe në raport me veten e tyre.

Në këtë rast do të trajtoj vetëm disa nga sektorët në të cilët ata janë të inkuadruar, duke qenë i vetëdijshëm se minoriteti serb është i kyçur në të gjitha institucionet, edhe më vitale të shtetit, Polici, Forcën e Sigurisë, Qeveri, Kuvend, etj., unë do të trajtoj vetëm disa nga ato.

Po ashtu do të trajtoj edhe disa nga veprimet kriminale që i kanë ndërmarrë dhe i ndërmarrin kohë pas kohe, por edhe në mënyrë permanente disa nga pjesëtarët e minoritetit serb që jetojnë në Republikën e Kosovës.

2 . SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE TË DREJTAT E MINORITETIT SERB SIPAS KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

Në vitin 1912 u bë shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe në këtë rast edhe pavarësisë së Kosovës si pjesë e territorit të gjithëmbarshtëm etnik. Pushtimi i saj nga trupat serbo-sllave bëri që Kosova të mbetet jashtë kufijve etnikë të Shqipërisë dhe në vitin 1913 ambasadorët evropianë ia falën Kosovën Serbisë.

Kosova u vendos nën okupimin e shtetit të atëhershme serb, e më vonë nën shtetin e Jugosllavisë, në të cilin shtet prapë Serbia dominonte mbi Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e pas shpërbërjes - rrënimit të kësaj Federate jugosllave, okupimi i Kosovës u radikalizua nga ana e Serbisë.

Që nga viti 1912 shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin popullatë shumicë, nuk iu ndërpre asnjëherë dhuna dhe shtypja diskriminuese në bazë race dhe etnie. Edhe gjatë tërë këtij rrugëtimi historik, ajo prapëseprapë në vete ishte një tërësi e veçantë, pa marrë parasysh emërimin e saj Krahinë

autonome në kuadër të Jugosllavisë, apo edhe si “pjesë e Serbisë” siç e quanin serbët.

Mëvetësia e saj e vërtetuar edhe në vitin 1990, kur ajo shpalli pavarësinë e saj nga shteti jugosllav, bashkë me shtetet e tjera të Jugosllavisë, ishte shtysë e mëtejme që shqiptarët në Kosovë të kuptojnë situatën e tyre reale dhe të rëndë nën okupimin e Serbisë.

Duke qenë se Serbia donte të jetonte mbi supet e të tjerëve dhe mbi ato supe të krekosej dhe të merrte primatin në çdo territor të asaj Jugosllavie, ajo shkaktoi luftëra në tërë hapësirën gjeografike që ajo preku, dhe ato luftëra pastaj çdo herë rezultonin me shkaputje të territoreve të cilat përfitonin pavarësinë.

E gjithë bota u bë dëshmitare e Serbisë në vurrjen e flakës zemrës së Ballkanit dhe me terrorin dhe gjenocidin ajo vrau me mijëra e mijëra të pafajshëm.

Së fundmi, edhe në Kosovë me dhunën dhe gjenocidin e vazhdueshëm bëri që më në fund shqiptarët të ngriten në këmbë dhe të rrokin armët në mbrojtje të vendit të tyre dhe ta bëjnë çlirimin e Kosovës.

Lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e saj e cila përfundoi në qershor 1999 i dha fund okupimit njëshekullor

serb, i hapi rrugën lirisë, e cila ishte ëndërr e shumë brezave në Kosovë dhe kjo liri solli edhe shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Kosova më datë 17 shkurt 2008 shpalli pavarësinë e saj.

Me Kushtetutën e saj është shpallur “shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm”⁶⁷ me synimin që të jetë shtet i barabartë me shtetet e tjera, shtet stabil dhe i pacenueshëm, shtet i patjetërsueshëm.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës u bë garanci e madhe për shqiptarët, por edhe për të gjithë banorët e tjerë në të, siç janë pakicat minoritare serbe, turke, rome, ashkalinje, etj. dhe dhuna e ushtruar në mënyrë sistematike nga okupatori ndaj shqiptarëve u bë mësim se si nuk duhet sjellë me të tjerët.

Republika e Kosovës në Kushtetutën e vet ka vënë themelet e një shteti demokratik, bazament i bërë me standardet më të larta që ka ndonjë kushtetutë e botës.

Duke qenë i vetëdijshëm se në Republikën e Kosovës përveç shqiptarëve jetojnë edhe minoritete të tjera, në aktin më të lartë juridik deklaroi se do të jetë e orientuar në respektimin

⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 1, par.1, Prishtinë, 2008

e të drejtave dhe lirive të të gjithë banorëve të saj, barazisë së tyre para ligjit, e duke cituar atë, ajo është për “mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”⁶⁸ në shtetin e Kosovës.

Në Kushtetutën e Republikës e Kosovës, edhe pse serbët janë pakicë minoritare, ata i gëzojnë të drejtat më të mëdha që mund t’i ketë ndonjë kushtetutë e ndonjë vendi tjetër për minoritarët e vet.

Po ashtu edhe në praktikë, edhe përtej Kushtetutës, serbët kanë më shumë të drejta edhe se minoritetet e tjera këtu në Kosovë, por edhe më shumë të drejta edhe se në shtetet e tjera⁶⁹.

Serbët gëzojnë gjuhën e tyre si gjuhë zyrtare⁷⁰, “qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën serbe, në

⁶⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, par.2, Prishtinë, 2008

⁶⁹ Në Letoni 1/3 e popullsisë është ruse dhe prapëseprapë gjuha ruse nuk është gjuhë zyrtare. Atje është zhvilluar referendum mbi këtë gjë në bazë të kërkesës së popullatës ruse, dhe prapëseprapë 75% e votuesëve kanë qenë kundër asaj që gjuha ruse të jetë gjuhë e dytë zyrtare në Letoni (Lajmet në Top News, E diel, 19.2.2012, ora 18:56)

⁷⁰ Kushtetutës e Republikës së Kosovës, Neni 5.1

mbarë Republikën e Kosovës”⁷¹, pastaj numër të caktuar të vendeve në Kuvend, “me minimum dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10)”⁷², njëri nga nënkryetarët është i rezervuar për t’u zgjedhur prej “komunitetit serb”⁷³, edhe në organet qeveritare, në Qeveri është caktuar një vend i ministrit i rezervuar “nga komuniteti serb”⁷⁴, dy zëvendësministra⁷⁵, pastaj vend të rezervuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ku dy anëtarë janë të caktuar për mandat pesëvjeçar që zgjedhen nga deputetët e Kuvendit nga minoriteti serb dhe shumë të drejta të tjera.

Pa marrë parasysh këto të drejta të rezervuara për minoritetin serb, ata nuk kanë treguar gatishmërinë e duhur që të pranojnë realitetin e ri, shtetin e pavarur të Kosovës.

Kjo kryeneqësi e tyre dhe mospranim realiteti me siguri është bërë edhe nga ndikimi i madh që ka qeveria e Serbisë, e cila

⁷¹ Po aty, neni 59, par. 11

⁷² Po aty, neni 64, par.2, pika 1

⁷³ Po aty, neni 67, par.4

⁷⁴ Po aty, neni 96, par.3

⁷⁵ Po aty, neni 96, par.4

nuk dëshiron që publikisht ta pranojë se Kosova tashmë është e pavarur dhe se okupimi i saj shekullor ka përfunduar dhe me këtë të dalë e pavërtetë historia që është mësuar në shkollat e tyre në raport me Kosovën, e në veçanti shqiptarëve.

Që nga viti 1999 bashkësia ndërkombëtare në Kosovë e ka ndier vetën si pjesë e lirisë së Kosovës, ku bombardimet e NATO-s i dhanë ndihmë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në luftën e saj për liri.

Edhe pse shumë shtete që morën pjesë në sistemin ndërkombëtar të pranishëm që nga viti 1999 nuk ishin pjesë e kontributit ndërkombëtar për çlirimin e Kosovës nga dhuna dhe okupimi serb, ato u bënë faktorë me rëndësi në ngritjen e strukturave shtetërore të shtetit të ri që do të lindte më 17 shkurt 2008.

Shteti i Kosovës në vete përmban standardet më të veçanta që ka ndonjë shtet dhe tërë këto standarde që ajo i ka pranuar dhe i pranon akoma i bën me sakrificë të madhe, me presion të pakuptueshëm nga shumë njerëz.

Republika e Kosovës është duke kapërdirë shumë dhimbje dhe dëshira, duke e nënshtruar veten nën nivelin e barazisë me të tjerët dhe atë, fatkeqësisht si pasojë e papërgatitjes

morale, njerëzore, arsyes së atdhetarizmit dhe patriotizmit fals dhe “modern”.

Bujaria dhe falja për krimet e bëra ndaj fëmijëve, grave dhe pleqve, të zhdukurve, akoma nuk kuptohet nga strukturat kyçe të Kosovës e as të Serbisë. Edhe pse nuk iu bëhet vonë, gatishmëria e shqiptarëve të Kosovës për të pranuar uljen në tavolinë me xhelatin e saj nuk është duke e kënaqur atë dhe nuk janë duke i kënaqur as të drejtat maksimale të rezervuara për ta.

Kjo gjë pa dyshim se është duke paraqitur pabarazi ndaj minoriteteve të tjetra në Kosovë, romëve, turqve, etj., nëse shihet me atë sy, të cilët janë të diskriminuar skajshmërisht në raport me serbët.

Dhe për këtë ndërkombëtarët thonë “politikë është kjo dhe e dimë që është e padrejtë”⁷⁶.

Për të parë më së miri përbërjen e popullsisë së Kosovës në hapësirën e saj, më së miri mund të paraqitet dhe të përshkruhet si në figurën në vijim:

⁷⁶ Intervistë me personin X1 nga EULEX-i, më datën 12.1.2012



Përbërja etnike e Republikës së Kosovës (2005)⁷⁷

⁷⁷ http://en.wikipedia.org/wiki/File:Kosovo_ethnic_2005.png, qasur më datën 8.2.2012.

3 . QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Republika e Kosovës ka krijuar të gjitha institucionet e duhura për funksionimin normal dhe sa më të mirë si shtet.

Ajo ka krijuar edhe më shumë institucione vetëm që minoriteti serb, i cili nuk po mund të mësohet me Republikën e Kosovës, të inkuadrohet në jetën e përditshme dhe institucionale.

Secili institucion ka rezervuar vende të veçanta, kryesisht për minoritetin serb dhe minoritetet e tjera, siç është Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë, Ministrinë e ndryshme, Komunitat, etj.

3.1. QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ POLICISË SË KOSOVËS

Policia e Kosovës fillimisht u quajt Shërbimi Policor i Kosovës deri në ditën e shpalljes së Pavarësisë së saj. Policia e Kosovës që nga themelimi i saj, ku ajo u themelua “në bazë të vendimit të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, Nr. 305,

të datës 1 korrik 1999”⁷⁸ në vete mbajti qytetarët e të gjitha kombësive.

Kështu ky institucion e kishte synimin kryesor shërbimin ndaj të gjithë qytetarëve pa asnjë dallim race, ngjyre, feje apo tjetër.

Në momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku krahas saj u zëvendësua emri i këtij institucioni nga Shërbimi Policor i Kosovës në Policia e Kosovës, serbët, pjesëtarë të këtij institucioni, nuk e pranuan këtë gjë.

Ata menjëherë i bënë bojkot Policisë së Kosovës, duke u larguar nga ajo.

Kështu, pothuaj të gjithë serbët u larguan nga puna e tyre, si reagim ndaj shpalljes së pavarësisë, si mosnjohje të saj dhe vendosen kushte për t’u kthyer, duke deklaruar se do të ktheheshin vetëm nëse s’do t’i jepnin llogari Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke kërkuar udhëheqje të mëtejme nga UNMIK-u.

⁷⁸ Sopjani, Enver, Die politisch-militärische und polizeiliche Rolle der internationalen Gemeinschaft in Kosova ab 1999, Berlin, 2010, f. 65

Për këtë gjë policët serbë të SHPK-së kanë deklaruar se “nuk dëshirojnë më të punojnë si pjesëtarë të policisë së ashtuquajtur shtetit të pavarur të Kosovës”⁷⁹.

Ky veprim i minoritetit serb u bë pa dyshim edhe nga ndikimi i madh që kishte dhe ka akoma Serbia në jetën e tyre, nga frika dhe kërcënimi që i bëhet, nga cilësimi i tyre në patriotë apo në tradhtarë, por edhe nga mospranimi i faktit se tani më shqiptarët nuk janë të dorës së dytë a të tretë.

Rebelimi dhe kundërshtia e tyre nuk zgjati shumë dhe kthimi i tyre në Policinë e Kosovës u bë shumë shpejt, duke e krahasuar më fjalën e madhe “kurrë”.

Kthimi u ndikua nga shumë faktorë të ndryshëm. Disa u kthyen si pasojë e kuptimit të realitetit dhe arsyeshmërisë për jetën në rrethin shoqëror, disa nga frika e ndaljes së pagave që ata merrnin pa punuar fare, frika e humbjes së vendit të punës dhe në fund me siguri kërkesa e zyrtarëve në Serbi për ndikim dhe qasje brenda Policisë së Kosovës. Tërë këto

⁷⁹http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=0, qasur më datën 26.1.2012.

arsye-faktorë bënë që ata u kthyen në punë prapë, nën komandën e Policisë së Kosovës, nën flamurin e shtetit të ri. Kështu, “më 30 qershor 2009, në një konferencë shtypi nga ana e Policisë së Kosovës u bë e ditur se shumica e policëve të pezulluar të pakicës serbe ishin kthyer në punë”⁸⁰.

Po ashtu, shteti i Kosovës, duke i plotësuar skajshmërisht kërkesat e minoritetit serb, atyre iu la komanda në stacionet dhe nënstacionet ku ishin me shumicë serbe, por edhe vende me rëndësi në strukturat udhëheqëse në hierarkinë e PK-së.

Kështu, në mungesë të njerëzve me shkollim adekuat, ka bërë që të merrnin pozita të larta edhe njerëzit pa shkollim adekuat dhe me diploma të falsifikuara, ku si pasojë e falsifikimeve disa nga ata u larguan nga policia.

Zgjedhja e komandantëve të stacioneve në komunitat ku udhëhiqen nga serbët u bë nga ndikimi politik⁸¹ i politikanëve në Kosovë dhe Serbi.

⁸⁰ Sopjani, Enver, *Military Policies and Policing in Kosova since 1999, The role of the International Community*, Berlin, 2011, f. 126

⁸¹ Intervistë me zyrtarin policor serb X-1, më datën 13.2.2012.

3.2. QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ INSTITUCIONEVE SHKOLLORE

Minoriteti serb kaloi në sistemin refuzues edhe në fushën e shkollimit.

Ata krijuan Universitetin e Prishtinës jo në Prishtinë, por selinë e saj e bënë në Mitrovicën e Veriut, atje ku ata e ndjejnë atë pjesë si Serbi.

Vetë shpallja e pavarësisë së Kosovës studentët serbë i organizoi në kundërshtinë e shtetit të ri.

Ata protestuan kundër pavarësisë së Kosovës për disa ditë me radhë në Mitrovicë, duke bërë brohoritje të ndryshme provokuese e në baza etnike dhe nacionaliste, ndër to: “Kjo është Serbi” dhe “Kosova është zemër e Serbisë”⁸².

Ky universitet ishte shumë i mirëpritur për ata serbë që ishin kyçur në institucionet e Kosovës, të cilët u pajisën me diploma false, por edhe për serbët që punonin në Serbi dhe diploma e Mitrovicës ishte e lehtë për t’u siguruar.

⁸²http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=9, qasur më datën 26.1.2012.

Kështu, abuzimet kanë qenë të mëdha si në shumë fusha e në shumë sektorë të ndryshëm, ku financimet që janë bërë nga ana e qeverisë serbe i ka kushtuar asaj shumë humbje dhe shumë keqpërdorime të natyrave të ndryshme.

Ka shpërthyer skandal lidhur me Universitetin e Mitrovicës, ku “mbi 1000 grada shkencore janë falsifikuar brenda viteve 1999-2004..., ku përfitues ishin pjesëtarë të policisë, koordinatorë të komunave, drejtorë të shkollave dhe zyrtarë të lartë politikë...rojat e urës, shumë prej të cilëve janë të regjistruar si studentë edhe pse nuk marrin pjesë në mësim”⁸³.

Kjo ishte vetëm njëra nga konkludimet e monitorimeve të ndryshme që u bënë.

⁸³ Serb Integration in Kosovo: Taking the plunge, Europe Report N°200-12 May 2009, Crisis Group, Working to prevent conflict worldwide, f. 17 (më gjerësisht: <http://www.crisisgroup.org>).

3.3. QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ INSTITUCIONEVE GJYQËSORE

Edhe ndaj sistemit gjyqësor minoriteti e kishte të njëjtën qasje, ku disa nga ata u kyçën në to, kurse disa nuk e pranuan këtë sistem juridik legjitim dhe legal.

Disa nga bojkotuesit kanë protestuar edhe para objekteve të gjyqësorit të Republikës së Kosovës, pikërisht në pjesën e veriore të Kosovës, në Mitrovicë.

Disa nga ata, duke mos dashur ta kuptojnë realitetin, duke jetuar në botën e iluzioneve “kanë protestuar para Gjyqit Komunal dhe të Qarkut në këtë qytet....njëqind ish-punëtorë të drejtësisë, duke kërkuar që këto institucione të kalojnë nën ingerencat e Minsitrisë së Drejtësisë të Serbisë”.⁸⁴

⁸⁴http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=27, qasur më datën 26.1.2012.

3.4 . QASJA E MINORITETIT SERB NDAJ KOMUNAVE

Republika e Kosovës në gjirin e saj i ka të krijuara një numër të konsiderueshëm të komunave, duke menduar se do të ketë funksionalitet më të mirë, për jetë më të mirë të qytetarëve të saj, inkuadrim dhe afërsi e tyre me pushtetin qendror. Nga 37 (tridhjetë e shtatë) komunat që janë, 7 (shtatë) nga to janë të udhëhequra nga të zgjedhurit e minoritetit serb.

Edhe këta të zgjedhur nga minoriteti serb, nga pjesa tjetër refuzuese shihet si veprim jo i drejtë. Edhe në këtë anë presioni i qeverisë së Republikës së Serbisë në banorët serbë të Kosovës shihet qartë.

Reagimet që janë bërë nga pushtetarët serbë ndaj serbëve që jetojnë në Kosovë, siç është edhe reagimi i zëdhënësit të Partisë Demokratike Serbe të Vojisllav Koshtunicës, Petar Petkoviq, nuk është asgjë tjetër veçse kërcënim për serbët të cilët do të marrin pjesë në zgjedhjet në Republikën e Kosovës

me atë se ”do të përjashtojmë nga partia jonë të gjithë ata anëtarë që marrin pjesë”⁸⁵.

Kërcënimi dhe manipulimi fëmijëror që tenton të bëjë Republika e Serbisë me banorët e saj në Republikën e Kosovës, duke deklaruar se ajo nuk do të heqë kurrë dorë nga Kosova, duke u thirrur se ajo do të vazhdojë luftën e saj “paqësore, diplomatike dhe ligjore për të mbajtur Kosovën e Metohinë brenda kufijve të saj”⁸⁶, është vetëm një premtim për varfanjakun se nesër do të jetë i kamur.

Kështu, secili aparat shtetëror i Republikës së Serbisë bën deklarime të cilat nuk i ndihmojnë asgjë minoritetit serb në Kosovë, përveç se i pengojnë në qasjen me kohë në institucionet e Republikës së Kosovës, duke krijuar dhe duke shtuar mëdyshjen ndaj realitetit, pa llogaritur se në fund ata do të dalin humbës.

⁸⁵ <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2010/12/07/feature-03> (Igor Ivanović për Southeast European Times në Beograd-07/12/10), qasur më datën 25.1.2012.

⁸⁶ <http://www.srbija.gov.rs/pages/article.php?id=20619>, qasur më datën 25.1.2012.

Edhe Asambleja Kombëtare e Republikës së Serbisë më 31 korrik 2011 ka bërë deklaratë me të cilën kërkon nga Qeveria e Republikës së Serbisë që të raportojë para kësaj Asambleje të paktën një herë në tre muaj, me qëllim që të kontrollojë se a janë duke u zbatuar aktivitetet e kësaj Asambleje në “mbrojtje të sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Republikës së Serbisë”⁸⁷.

Me këtë dëshmohet se Serbia tenton që manipulimi i saj ndaj banorëve serbë në Kosovë të jetë i vazhdueshëm dhe i pandërprerë, duke krijuar bindjen dhe opinionin se asaj “i bëhet vonë për ta”.

Ajo ka krijuar edhe ministri të veçantë të quajtur Ministria për Kosovën që “të dëshmojë” se ata nuk heqin dorë prej Kosovës.

Serbia ka krijuar dhe financon shumë njerëz të ndryshëm të sistemuar në struktura ilegale dhe vepron në Kosovë, edhe pse në opinionin e jashtëm nuk pranon se i ka krijuar dhe se i përkrah këto struktura.

⁸⁷ http://www.srbija.gov.rs/extfile/en/78640/declaration_kosovo-metohija310711_eng.doc, qasur më datën 25.1.2012.

Sekretari i Ministrisë për Kosovën i Republikës së Serbisë, Oliver Ivanović, thotë se “Serbia nuk ka asnjë njësi policore apo strukturë të sigurisë... ka të drejtë dhe detyrim të përkujdeset për sigurinë e qytetarëve të saj. Institucionet serbe janë ato të vetmet që i ofrojnë këto shërbime dhe të cilave serbët u besojnë”⁸⁸, lidhur me reagimin e saj ndaj Grupit Drejtues Ndërkombëtar dhe kërkesës së tyre që Serbia t’i shpërbëjë strukturat paralele.

Me vetë deklaratën e tij Ivanović pranon se në Kosovë ka struktura të sigurisë të shtetit serb dhe se ajo e paska “detyrim” të përkujdeset për serbët në Kosovë.

Këtë gjë disa e kanë kuptuar se është vetëm farsë e politikës ditore, patriotizmit të dalë mode dhe janë futur në kanalet e realitetit.

Njëri ndër ta është edhe kryetari i Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanović, i cili në momentin e marrjes së pushtetit në këtë komunë, dalë nga zgjedhjet lokale të vitit 2009, ka deklaruar se “krijimi i Komunës së Graçanicës është një

⁸⁸ RTK, Lajmet Qëndrore, ora 19:30, data 25.1.2012 (Serbia nuk pranon t’i shpërbëjë strukturat paralele në Kosovë).

moment historik për serbët e Kosovës, sepse ata do të kenë një shansë për jetë më të mirë në Kosovë”⁸⁹.

Republika e Kosovës në gjirin e saj mban dy llojë struktura serbësh, si p.sh. dy kryetarë komunash, një legale e një ilegale, dy ministra, njëri legal e tjetri ilegal. Njëri zgjedhet nga vota e dalë në zgjedhje legale të Republikës së Kosovës, kurse tjetri zgjedhet nga vota e dalë nga zgjedhje ilegale të Republikës së Serbisë të mbajtura në territorin e Kosovës.

Këto lloj zgjedhjesh mbahen për qëllime të bojkotit të Republikës së Kosovës, ku në fillim të vitit 2012 kryetarët e strukturave paralele, siç është ai i Mitrovicës, Krstimir Pantiq, ka organizuar edhe referendum në Mitrovicë lidhur me atë se a dëshirojnë serbët e Kosovës të jetojnë në Republikën e Kosovës apo jo.

Ky veprim i cekur i bërë me prapavijë politike, e përgatitur nga Akademia e Serbisë, e vë në pah qëndrimin e përhershëm të disa serbëve, të cilët ndikojnë te të tjerët, lidhur me qasjen

⁸⁹ <http://kk.rks-gov.net/gracanice/News/The-first-constitutive-session-of-Municipal-Assemb.aspx>, qasur më datën 26.1.2012.

ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, në të cilën ata jetojnë.

Qytetarët reagojnë në mënyrë të ndryshme ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Ata besojnë se duhet mbajtur referendume të tilla për qëllim që para kamerave të dalin patriotë serbë.

Për këtë rast, një qytetar që jeton në Veriun e Mitrovicës deklaroi se “duhet patjetër t’iu tregojmë se nuk i pranojmë institucionet e Kosovës”⁹⁰, kurse qytetari tjetër deklaroi se “do të marr pjesë në referendum me qëllim që t’ua bëj me dije se kjo pjesë është serbe”⁹¹.

Këto deklarimi dëshmojnë më së miri ikjen nga realiteti dhe konfuzitetin që ata mund të krijojnë te të tjerët.

Organizatori kryesor i këtij referendumi, kryetari i Komunës paralele të Mitrovicës, Pantiq, deklaroi se nëpërmjet referendumit të datës 14 dhe 15 shkurt 2012 ata dëshirojnë t’u “dërgojnë mesazh shqiptarëve të Kosovës dhe një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare që i përkrah dhe disa partive politike në Beograd se nuk i pranojnë institucionet e Kosovës

⁹⁰ Televizion Klan Kosova, datë 13.02.2012, Lajmet e orës 20:00, sakt. 20:21 min.

⁹¹ Po aty.

dhe asnjëherë nuk do të pranojnë të jetojnë në Republikën e Kosovës”⁹².

Ky deklaram është i bazuar në politikën e shtetit serb, e jo në jetën dhe kushtet reale që dëshirojnë disa nga serbët e rëndomtë.

Serbët e rëndomtë të Kosovës janë nën presionin e radikalëve serbë të Mitrovicës së Veriut, të cilët “të pakënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve serbë në referendum kanë kërcënuar banorët e atjeshëm se nuk do t’i marrin pagat nëse nuk votojnë”⁹³.

Pavarësisht tërë këtyre presioneve të bëra si nga Serbia jashtë Kosovës, ashtu edhe Serbia brenda Kosovës nëpërmjet radikalëve serbë, disa nga serbët e rëndomtë në Kosovë në vazhdimësi kanë tentuar të futen në jetën institucionale të Republikës së Kosovës. Presioni i pandërprerë i të gjitha mënyrave që u bëhet atyre (disa e dëshirojnë edhe vetë këtë mishmash politik) ndikon në masë të madhe në inkuadrimin dhe angazhimin e tyre në shtetin e Kosovës.

⁹² Po aty.

⁹³ Gazeta Zëri, e mërkurë, 15.2.2012, ballina, “Referendum nën kërcënim”.

Më së shumti janë duke hasur në pengesë serbët e veriut, të cilët me siguri ndikojnë shumë faktorë, e ndër këta edhe “ngacmimet dhe kërcënimet nga forcat paralele serbe të sigurisë, nga mobilizimi i forcave politike radikale serbe...”⁹⁴ aty ku pushtetin dhe mbikëqyrjen në fakt nuk e ka Republika e Kosovës.

⁹⁴ KIPRED, Decentralizimi në Kosovë I: Zgjedhjet komunale dhe pjesëmarrja e serbëve, Prishtinë, dhjetor 2009, f. 3.

4 . FINANCIMI I SERBISË NË MINORITETIN SERB TË KOSOVËS

Beogradi i financon serbët e Kosovës për disa arsye, e më kryesorja është “për t’i inkurajuar ata që të qëndrojnë në Kosovës; për të siguruar prova të dukshme të pranisë së vazhdueshme shtetërore të Serbisë; dhe për politikanët të ruajnë kontrollin përmes rrjeteve të patronazheve”⁹⁵.

Ky financim i Serbisë në Kosovë për minoritetin serb nuk ka kaluar pa keqpërdorime të mjeteve nga strukturat e caktuara udhëheqëse serbe që veprojnë këtu.

Kjo gjë qeverisë serbe i ka shkaktuar humbje të madhe, e cila për këtë arsye ka filluar ta reduktojë me të madhe këtë financim.

Kështu, personat që kanë punuar në institucionet paralele Serbe në Kosovë, siç janë mjekët, komunarët, mësuesit etj., të cilët kanë pasur rroga të majme “rreth 3.000 € në muaj”⁹⁶, shumica prej tyre edhe rroga të dyfishta, si nga qeveria e

⁹⁵ Serb Integration in Kosovo: Taking the plunge, Europe Report N°200 - 12 May 2009, Crisis Group, Working to prevent conflict worldwide, f. 15 (më gjerësisht: <http://www.crisisgroup.org>).

⁹⁶ Po aty, f. 17.

Kosovës, ashtu edhe nga ajo serbe, kanë reaguar në reduktimin e këtyre të ardhurave – pagesave.

Reagimi ka qenë i atillë ku shumë prej tyre kanë lënë punën dhe janë larguar në Serbi, ku këto veprime dhe reagime për reduktim të pagesave kanë sjellë edhe kërcënime për largim nga Kosova.

Me këtë reagim të qeverisë serbe për serbët në Kosovë ishte një porosi serioze se ata për të qëndruar në Kosovë duhet bërë më kursimtarë dhe se duhet “shtrenguar rripin”⁹⁷.

⁹⁷ Po aty, f. 16.

5 . STRUKTURAT KRIMINALE TË ARMATOSURA SERBE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Serbia në çdo mënyrë tenton t'u tregojë qytetarëve të vet serbë se ajo nuk heq dorë lehtë nga Kosova.

Ajo këtë veprim e bën në mënyra të ndryshme për t'u treguar qytetarëve në Serbi se ajo akoma është e fuqishme në raport me shtetet e tjera fqinje, për t'u treguar qytetarëve të saj serbë në Kosovë se ajo është dominuese akoma në Kosovë.

Ajo që nga përfundimi i luftës në Kosovë menjëherë në vitin 1999 organizoi struktura të armatosura dhe i vendosi pothuaj në çdo vend ku kishte popullatë më të përqendruar të minoritetit serb në Kosovë, e më së shumti në Verin e Kosovës. Pikërisht në urën e lumit Ibër vendosi njerëz të armatosur, të cilët u quajtën Rojat e Urës që e konsideronin veten si përgjegjëse të sigurisë dhe në gjirin e tyre anëtarët e saj ishin kriminelë, pjesëtarë të MUP-it serb, etj.

Ata kishin tri funksione kryesore, ndër to: “Të parandalojnë hyrjen e shqiptarëve të Kosovës në Mitrovicën veriore; të grumbullojnë informata mbi Forcën e Kosovës (KFOR) dhe Policinë Civile (CIVPOL); dhe të grumbullojnë informata për çdo shqiptar të Kosovës që jetonte në veri... Kah fundi i vitit

1999, Rojat e Urës ishin organizatë e strukturuar që aktivitetet e veta i koordinonte me ndihmën e radiove dhe formave të tjera të komunikimit”⁹⁸.

Pastaj, krahas kësaj strukture kriminale në Republikën e Kosovës Serbia kishte dhe ka aktivë edhe anëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në këtë rast përfshihen “ish-oficerët e policisë në Mitrovicë (që ishin para luftës së Kosovës) dhe ata që janë dërguar nga Serbia për të grumbulluar informata”⁹⁹.

Këto struktura të MPB-së në vazhdimësi pësuan ndryshime. Oficerët e MPB-së nga Mitrovica kanë mbajtur një prani të pandryshueshme në këtë rajon, ndërsa oficerët nga Serbia me kalimin e kohës janë ndërruar me rotacion.¹⁰⁰

Edhe në Policinë e Kosovës Serbia ka dislokuar anëtarë të strukturave të tyre të sigurisë, ish-oficerë të MPB-së që kanë

⁹⁸ <http://www.osce.org/sq/kosovo/24619>, faqe 27, Strukturat paralele në Kosovë 2006-2007, OSCE, Misioni në Kosovë, Departamenti për të drejtat e njeriut, Decentralizim dhe Komunitete.

⁹⁹ Po aty, f. 34.

¹⁰⁰ Po aty.

vepruar në Kosovë, por edhe “oficerë të MPB-së që janë dërguar nga Serbia”¹⁰¹.

Në Republikën e Kosovës ka edhe anëtarë të strukturave të ndryshme shtetërore të sigurisë me qendër në Serbi. Këtë gjë e kanë dëshmuar edhe vetë zyrtarët e lartë të tyre.

Kryetari i Kuvendit Komunal (KKK) të Zveçanit më 2 qershor 2006 ka deklaruar se “385 anëtarë të personelit civil administrativ nga Ushtria Jugosllave (UJ) do të dislokohen në Kosovën veriore. KKK më vonë mohoi të ketë bërë ndonjëherë një deklaratë të tillë”¹⁰², gjë e cila është bërë me qëllim që për minoritetin serb të dëshmohet se Serbia është aktive në përkrahjen e tyre dhe, në anën tjetër, për t’i thënë botës se nuk është e vërtetë ajo gjë.

Për ekzistimin e këtyre strukturave kriminale serbe në Kosovë ekzistojnë shumë dëshmi. Njëra ndër to është bllokimi i rrugëve në Veri të Republikës së Kosovës, barrikatat që u vendosën pothuaj në tërë rrugët që e lidhnin veriun e Kosovës me pjesën tjetër të Kosovës.

¹⁰¹ Po aty, f. 28.

¹⁰² Po aty, f. 30.

Këto barrikada u vendosën në pjesën e dytë të vitit 2011 dhe, edhe pse në sy të parë shiheshin se aty kishte edhe gra, fëmijë, pleq, në to e vërteta ka treguar se janë kryer edhe krime dhe kishte edhe viktima.

Kështu, më 25 korrik 2011 nga snajperët serbë u vra polici i Kosovës, Enver Zymberi, i cili ishte në detyrë zyrtare në mbrojtje të rendit dhe sigurisë në Republikën e Kosovës.

Ai u vra nga kriminelët serbë vetëm se ishte pjesë e atyre që kishin qëllim vendosjen e rendit e sigurisë, që kishin për qëllim luftimin e kriminelëve.

Po ashtu, edhe ndaj ushtarëve të KFOR-it në fund të nëntorit 2011 u ushtrua dhunë, e cila rezultoi me plagosjen e 25 ushtarëve gjermanë dhe me këtë dëshmuar se ata nuk ishin asgjë tjetër veçse grupe kriminale, të dhunshme, të vendosura për bllokime të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

Për këtë arsye kancelarja gjermane Merkel, gjatë vizitës së saj në Kosovë që i bëri trupave të KFOR-it gjerman dhe në takimin e saj, më 19 dhjetor 2011 ka dërguar porosi ndaj

Serbisë, duke thënë që “Kosova është një shtet i pavarur dhe strukturat paralele serbe nuk kanë vend në këtë shtet”.¹⁰³

Ajo ishte shumë e ashpër ndaj Serbisë, e cila tenton ta paraqesë faqen e saj demokratike, duke fshehur faqen tjetër kriminale, e cila me shekuj ka qenë dhe është e atillë.

Mesazhin që ajo ka dërguar për Serbinë, që ajo të jetë e gatshme për dialog dhe zgjidhje të problemeve nëpërmes dialogut, mediat serbe e kanë shtrembëruar pa masë dhe me siguri këto shtrembërime ndikojnë edhe te qytetarët e thjeshtë.

Vetë deklarimi i mediave serbe lidhur me këtë takim nxit te popullata e thjeshtë reagim dhe tensione.

Kështu, shtrembërimi ka shkuar deri në atë masë sa ata kanë thënë se kancelarja Merkel ka kërcënuar serbët e Kosovës me përdorim të forcës ushtarake përveç asaj politike dhe këtë gjë Beogradi duhet ta kuptojë se “kjo nuk është asgjë tjetër përveç kërcënim i armatosur, në të cilin Beogradi duhet të reagojë”.¹⁰⁴

¹⁰³<http://www.panorama.com.al/bota-rajoni/merkel-ne-prishtine-jo-struktura-paralele-serbe/>, qasur më datën 14.02.2012.

¹⁰⁴<http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/189018/Angela-zapretila-Srbima>, qasur më datën 14.02.2012.

Kurse, për të dëshmuar me fakte veprimtarinë kriminale që bënë Serbia brenda Republikës së Kosovës është edhe aksioni që ka ndërmarrë Policia e Kosovës më datë 25 shkurt 2012 në Gjilan.

Policia e Kosovës ka bërë kontrollime në shtatë lokacione të ndryshme në komunën e Gjilanit, ku kanë arrestuar gjashtë persona, të cilët kanë qenë pjesëtarë të MPB-së të Serbisë.

Ata dyshohet se kanë qenë duke kryer veprimtari kriminale dhe nga ta janë konfiskuar armë, uniforma të policisë të Serbisë, kartela identifikimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme e dokumente të tjera.

Ata në këtë rast janë akuzuar për veprën penale të Sulmit kundër Rendit Juridik të Kosovës dhe Pengim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave në institucionet e Republikës së Kosovës.

Arrestimi i këtyre gjashtë personave është bërë falë informatave që kanë dhënë banorët serbë të Komunës e Parteshit.

Të arrestuarit janë: “Z. Deniq, M. Dimitrieviq, T. Deniq, N. Trajkoviq, D. Stojkoviq dhe G. Matrapazoviq”.¹⁰⁵

¹⁰⁵ E shtunë, 25 shkurt 2012, RTK, Lajmet Qendrore 19:30 h, pastaj TopNews, 25 shkurt 2012, 18:32 h, etj.

Ky veprim i minoritetit serb është dëshmi se si duhet të bashkëpunojnë me institucionet e Republikës së Kosovës.

6. PËRMBLEDHJE

Minoriteti serb në Republikën e Kosovës, edhe pse duke qenë se është në numër shumë të vogël të popullsisë, gëzon të drejta të shumta, të cilat janë rezervuar me Kushtetutë dhe me ligje të tjera.

Qasja e tyre ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës nuk është në nivel të cilin vlenë për t'u vlerësuar, ku në bazë të fakteve të trajtuara shumica prej tyre nuk i respektojnë këto institucione.

Politika e Serbisë që ndjek në raport me Republikën e Kosovës ndikon me të madhe në hutinë e minoritetit serb ndaj institucioneve të Kosovës.

Serbët e Kosovës në momente kur edhe janë duke u futur në rrjedhat institucionale të vendit ku jetojnë, radikalët serbë në Serbi bëjnë skena nxitëse, reagime dhe presione të cilat ngjallin pezmin e fshehur të disa serbëve të Kosovës, të cilët pastaj pa dyshim ndikojnë edhe te të tjerët.

Kjo sjell vetëm pengesa në jetën e tyre normale, humbje kohe duke bërë “sallta” nën shenjat e patriotizmit nationalist sllav, nën ëndrrën e disave për djepin e humbur serb.

Serbët duhet ta kuptojnë se institucionet nuk janë vetëm për t'u shfrytëzuar financiarisht, por për të kontribuar në to.

Kur munden kriminelët serbë të gjejnë gjuhën e bashkëpunimit me disa kriminelë shqiptarë, edhe serbët e tjerë duhet të bashkëpunojnë me institucionet.

Qasja pozitive ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës për minoritetin serb sjell vetëm përfitime që nuk i kanë as vetë shqiptarët.

Minoriteti serb prapëseprapë nëse do të jetë më i mençur do t'i shfrytëzojë në maksimum këto përfitime që janë duke ua afruar institucionet e Republikës së Kosovës atyre.

Veprimet e tyre kriminale që bëjnë kohë pas kohe vetëm sa përkeqësojnë raportet e tyre me shqiptarët si shumicë në Republikën e Kosovës, vetëm se do të jetë më potencial dëmtimi i tyre në kohë.

7. LITERATURA

Gazeta Zëri, E mërkurë, 15 shkurt 2012.

http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=9.

http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=27.

<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2010/12/07/feature-03> (Igor Ivanoviç për Southeast European Times në Beograd-07/12/10).

<http://www.srbija.gov.rs/pages/article.php?id=20619>.

http://www.srbija.gov.rs/extfile/en/78640/declaration_kosovo-metohija310711_eng.doc.

<http://kk.rks-gov.net/gracanice/News/The-first-constitutive-session-of-Municipal-Assemb.aspx>.

<http://www.osce.org/sq/kosovo/24619>, (Strukturat paralele në Kosovë 2006-2007, OSCE, Minsioni në Kosovë, Departamenti për të drejtat e njeriut, Decentralizim dhe Komunitete).

<http://www.panorama.com.al/bota-rajoni/merkel-ne-prishtine-jo-struktura-paralele-serbe/>.

<http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/189018/Angela-zapretila-Srbima>.

http://en.wikipedia.org/wiki/File:Kosovo_ethnic_2005.png.

http://glassrbije.org/A/index.php?option=com_content&task=archivecategory&id=0&year=2008&month=2&module=1&limit=9&limitstart=0.

Intervistë me personin X1 nga EULEX-i, më datën 12.1.2012.

Intervistë me zyrtarin policor serb X-1, më datën 13.2.2012.

KIPRED, Decentralizimi në Kosovë I: Zgjedhjet komunale dhe pjesëmarrja e serbëve, Prishtinë, dhjetor 2009.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008.

Sopjani, Enver, Die politisch-militärische und polizeiliche Rolle der internationalen Gemeinschaft in Kosova ab 1999, Berlin 2010.

Sopjani, Enver, Military Policies and Policing in Kosova since 1999, The role of the International Community, Berlin 2011.

Serb Integration in Kosovo: Taking the plunge, Europe Report N°200 - 12 May 2009, Crisis Group, Working to prevent conflict worldwide, (<http://www.crisisgroup.org>).

Televizioni i Kosovës, RTK, E shtunë, 25.1.2012 dhe 25.2.012.

Televizioni TopNews, E diel, 19 dhe 25.2.2012.

Televizioni Klan Kosova, më datën 13.2.2012.

8. SHKURTESAT

| | |
|--------------|---|
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë |
| KFOR | Forca e Kosovës |
| KKK | Kryetari i Kuvendit Komunal |
| MUP | Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| OKB | Organizata e Kombëve të Bashkuara |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| RTK | Radio Televizioni i Kosovës |
| UNMIK | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |

AUTORËT

Enver Sopjani

Enver (Halim) Sopjani, profesor në Universitetin e Prizrenit, ligjëron që nga viti 2010 në Universitete të ndryshme Gjermane (Bremen, Göttingen dhe Münster). Në vitin 2011 ka qenë Prorektor për Mësim dhe Hulumtime si dhe ushtrues detyre i Rektorit në Universitetin e Prizrenit. Në Gjermani është anëtar i disa asosacioneve të ndryshme shkencore. Studimet themelore, kryesore, magjistraturën dhe doktoratën i ka të kryera në Gjermani. Është magjister i Shkencave Politike, Kriminologjisë dhe Psikologjisë dhe doktor i Shkencave Politike (Dr.phil.). Po ashtu është në prag të doktoratës së dytë në Shkencat Juridike (Dr.jur.), po ashtu në Gjermani. Ka të publikuara disa publikime shkencore vendore dhe ndërkombëtare (pasqyra në: www.enversopjani.npage.eu). Që nga viti 1997 është edhe përkthyes zyrtar gjyqësor në Gjermani, ku deri më tani ka marrë pjesë në qindra seanca të ndryshme gjyqësore si në fushën penale, ashtu edhe në civile dhe administrative, gjë që kanë ndikuar në thellimin e njohurive që lidhen edhe me praktikën e sistemit të drejtësisë gjermane.

Kontakti: sopjanienv@yaho.de
enver.sopjani@uni.prizren.com
www.enversopjani.npage.eu

Naser Sopjani

Naser (Halim) Sopjani ka përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Studimet Master i ka përfunduar po në të njëjtin fakultet, në drejtimin Juridiko-Penal, tema e mbrojtur e Masterit “Vrasjet e rënda në rajonin e Prishtinës gjatë periudhës 2005-2009”. Tani është doktorant në Universitetin Europian të Tiranës, në Tiranë, Drejtimi Penal. Ka të publikuar një punim shkencor ndërkombëtar (Aggravated murder by Albanian Canons, GRIN Verlag, München 2011, ISBN 978-3-656-07956-9) dhe tri libra (Lufta e UÇK-së në Malësinë e Gollakut, Grashticë, Keçekollë/ Prishtinë 2012; Unë dhe i Panjohuri -Ditarë lufte-, Prishtinë 2012; Muza, Grup autorësh, Prishtinë 1998).

Kontakti: nasersopjani@hotmail.com

ISBN 978-9951-8867-0-3



9 789951 886703